



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i
Shqipërisë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Elda Zotaj

2. PhD. Albana Tole

Qershor /2025

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënieve dhe Institucioneve
Ndërkombëtare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i
Shqipërisë”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 240, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE / 3 PAK v.a. 2023-2024 14 PAE / 2 PAK v.a. 2022-2023 8 PAE / 1 PAK v.a. 2021-2022
18	Numri i studentëve:	17 Studentë v.a. 2023-2024 15 Studentë v.a. 2022-2023 16 Studentë v.a. 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”, ofrohet nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Njësia kryesore ku bën pjesë ky program studimi është Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe njësia bazë që e ofron këtë program është Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Programi në proces të vlerësimit të jashtëm bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare” ka ardhur nga riorganizimi i programit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”, licensuar me VKM Nr. 177, datë 19.02.2009 dhe akredituar me Urdhër Nr. 124, datë 29.03.2012 dhe VBA Nr. 64 datë 28.09.2018 me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Me vendim të UMAS Nr. 240, datë 19.07.2021, u miratua riorganizimi dhe riemërtimi i programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane përbëhet nga katër departamente: Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave; Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë; Departamenti i së Drejtës; Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë, të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve në arsimin e lartë.

Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”, ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, 180 ECTS dhe kohëzgjatje 3 vit akademike / 6 semestra. Programi i studimit i përket nivelit 6-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standardet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me stafet drejtuese dhe akademike të programit të studimit, GVJ konstatoi se ka një vemendje të vazhdueshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjes në karrierën akademike e profesionale të stafit akademik, duke marrë pjesë në aktivitete kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Studentët e këtij programi studimi vlerësuan se ata mbështen nga stafi akademik, duke u përfshirë në konferencat studentore me tematika relevante për programin e studimit, e të tjera aktivitete të UMSH.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që UMSH ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces në institucionin të zhvilluar në datat 18 dhe 19 nëntor 2024 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më reale situatën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof.Asoc.Dr. Elda Zotaj dhe PhD. Albana Tole. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Muhamed Prezja, koordinator teknik i ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të Vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”, si edhe ofron rekomandime të cilat mund të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të profesionistëve të rinj në shkencat politike.

Me datw 19.05.2025, GVJ dwrgoi pranw IAL-sw draft rvj-nw nwpwrmjet sistemit AMS. Me datw 30.05.2025, UMSH-sw objeksionet e saj, mbi te cilat GVJ shprehet si mw poshtw:

1. Lidhur me objeksionin dhe detajimet e dhëna nga institucioni rreth rekomandimit të bërë nga GVJ mbi Standardin IV.4; kriteri 6 (RVJ; fq.43); *në kuadër të ndërkombëtarizimit, ti kushtojë vëmendjen e duhur publikimit të çdo informacioni në faqen e tij web zyrtare edhe në gjuhën angleze, duke konsideruar dhe sqarimin që është dhënë nga GVJ mbi kriterin 6 “Në faqen zyrtare web të UMSH gjendet informacion për programet e studimit, partnerët, aktivitetet e ndryshme, etj. Në disa raste, GVJ konstatoi se informacionet në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara dhe për disa mungon një bio e shkurtër prezantuese. Gjithashtu, GVJ vëren që një pjesë e artikujve dhe informacioneve të publikuara ofrohen vetëm në gjuhën shqipe. GVJ rekomandon që institucioni, në kuadër të ndërkombëtarizimit, ti kushtojë vëmendjen e duhur publikimit të çdo informacioni në faqen e tij web zyrtare në dy gjuhë.”*

Rekomandimi që ka dhënë GVJ **qëndron** dhe sqarimet që ka dhënë institucioni së bashku me linkun ku aksesohet informacioni i ndërkombëtarizimit nuk përjashton gjetjet dhe analizën e GVJ. Konsiderimi i këtij elementi nga institucioni për të publikuar



çdo informacion në dy gjuhë i shërben njohjes edhe më të mirë nga të gjithë të interesuarit të aktivitetit dhe veprimtarive të tij. Gjithashtu, GVJ thjeshtë ka rekomanduar “ti kushtojë vëmendjen e duhur” standardi është vlerësuar “Përmbushet plotësisht”.

2. Lidhur me objeksionin dhe detajimet e dhëna nga institucioni rreth rekomandimit të bërë nga GVJ mbi Standardin IV.5; kriteri 4 dhe konkluzionet (RVJ; fq.45); *Institucioni nuk raporton pasqyra financiare me një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit.* Në objeksionin dhe sqarimet e bëra nga institucioni nuk angumentohet egzistenca e pasqyrave financiare deri në nivel programi studimi. Padiskutim që institucioni përgjigjet “sikundër kërkohet nga legjislacioni tatimor në fuqi raporton dhe publikon Pasqyrat Financiare për çdo vit fiskal sipas formatit të detyrueshëm si dhe kryen auditime të pavaruara nga kompani auditit të certifikuara, të përvitshme, si edhe auditime të brendshme nga strukturat e UMSH, dhe disponon Pasqyrat Financiare dhe raportet vjetore të auditimit, në përputhje edhe me aktet rregullative institucionale. Auditit i jashtëm në UMSH realizohet nga Crowe Howarth AI, ku raportet e përvitshme certifikojnë qëndrueshmërinë dhe mjaftueshmërinë financiare të Institucionit duke evidentuar se UMSH plotëson të gjitha standardet e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të aktivitetit për vitet e ardhshme, por kjo nuk plotëson kërkesën e parashikuar në këtë kriter. Konstatimi i GVJ **qëndron**.
3. Lidhur me objeksionin dhe detajimet e dhëna nga institucion rreth rekomandimit të bërë nga GVJ mbi Standardin V.1; konkluzionet (RVJ; fq.48); *Gjithsesi GVJ kërkon që kriteret e pranimet për këtë program studimi të publikohen në faqen web si dhe të përcaktohen kuota të veçanta për studentët nga trojet.* Sqarimi i institucionit se “Pranimet është një rubrikë e veçantë dhe e dukshme ndër listat e rubrikave të faqes së UMSH. Në çdo fillim viti akademik, institucioni ynë merr masa për shpalljen e kuotave për çdo program studimi në të gjitha ciklet e studimit”. Këtë të dhënë e kemi konfirmuar edhe përgjatë takimeve në UMSH me GVJ. Ju lutem, referojuni edhe njëherë linkut: <https://www.umsh.edu.al/e/143/pranimet>

GVJ e rishikojë edhe njëherë faqen zyrtare, pikërisht rubrikën “Pranimet” dhe po citojmë mënyrën sesi janë paraqitur aty:

Procesi i pranimeve në arsimin e lartë është i standartizuar me udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Plotësimi i formulareve A1 dhe A1Z nga ana e maturanteve shënon dhe hapin e parë të rëndësishëm për zgjedhjen e programeve të studimit.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është mbështetur në kriteret shtetërore të notës mesatare për të përcaktuar përparësinë në regjistrim në programet e zgjedhura.

Universiteti ka kthyer në traditë stimulimin e kandidatëve që zgjedhin UMSH, për të ndjekur studimet në momentin e këshillimit të karrieres.

Shënimi i GVJ është që “për këtë program studimi të publikohen në faqen eeb si dhe të përcaktohen kuota të veçanta për studentët nga trojet” në asnjë rubik të faqes zyrtare nuk gjetëm të dhëna për kuotat apo të nominuar për çdo program studimi mbi formën

dhe kriteret e pranimit pavarësisht se sipas përshkrimit në faqe të rubrikës “pranimet” janë për çdo program njësoj. Rekomandimi i GVJ mednojmë se i shërben institucionit dhe rekomandimi i GVJ-së **qëndron**.

4. Lidhur me objeksionin dhe detajimet e dhëna nga institucion rreth rekomandimit të bërë nga GVJ mbi Standardin VI.4; kriteri 1; kriteri 5 dhe konkluzionet (RVJ; fq.66); Gjithsesi, GVI i qëndron mendimit më sipër që pjesë e NJSBCZHC duhet të jetë edhe një ekspertë i jashtëm. Përsa më lartë sqarimi i dhënë nga institucioni se: “Duke pasur në vëmendje rëndësinë që Universiteti Mesdhetar i jep ruajtjes së standardeve të cilësisë, NJSBCZHK dhe njësia bazë që ofron programin e studimit përkatës, luajnë një rol thelbësor. NJSBCZHK në bashkëpunim me njësinë bazë kujdeset që në monitorimet sipas planit të punës vjetore të miratuar, të përfshijë edhe elementë të jashtëm në monitorime, duke shfrytëzuar të gjitha kontaktet që ka njësia bazë me lektorët e jashtëm, apo aktorë të tjerë të fushës së programit të studimit. Sugjerimet e tyre ndihmojnë njësinë bazë që të përmirësojë, apo të ruajë cilësinë e programit të studimit të caktuar. Këta aktorë të jashtëm që njësia bazë apo institucioni ynë ka marrëveshje, janë gjithnjë pjesë e aktiviteteve të UMSH dhe kontributi, mendimet apo idetë e tyre që programet e studimit të jenë sa më koherente, janë gjithnjë të vlerësuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”, nuk argumenton gjetjet dhe rekomandimin e ekspertëve. Konstatimi dhe rekomandimi i GVJ **qëndron**.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.64, datë 28.09.2018, "Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, bachelor në "Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci" të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" *nuk vlejnë për këtë program pasi ky është një program i riorganizuar dhe riemërtuar sipas Urdhërit nr.240 datë 19.07.2021.*





**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare”, i ofruar nga Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane (FDSHH) të UMSH, është riorganizuar dhe riemërtuar sipas Urdhërit nr.240, datë 19.07.2021 që të jetë në harmoni me interesat kombëtare të vendit, duke kontribuar në formëzimin e specialistëve të fushës. Në Statutin e Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë, është përcaktuar se <i>“Vizioni i UMSH është krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor, i cili ofron vlera të vërteta qytetarie dhe profesionalizmi; nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatis qytetar të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv dhe në përputhje me interesat kombëtare.”</i>(neni 4 i statutit) Gjithashtu në misionin e tij thuhet se <i>“UMSH do të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe të interesave të zhvillimit të vendit”.</i> (Statuti, fq.3-4) Programi i studimit është përgatitur për të pajisur studentët me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme që të jenë konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe të formojnë baza për t’u integruar në tregun e punës apo për të vijuar avancime të mëtejshme akademike. <i>Evidenca I Statuti i UMSH.</i> https://www.umsh.edu.al/c/14/misioni-dhe-filozofia
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare”, është në përputhje me misionin dhe fushën e veprimtarisë së UMSH dhe planin strategjik të zhvillimit të tij. Më konkretisht, në planin strategjik i Zhvillimit të institucionit ka të përcaktuar në misionin e tij tu jap <i>“...studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm; t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira, dijes, shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare”.</i> Në dokumentin e titulluar “Strategjia e Zhvillimit të Programit” thuhet se: <i>“Misioni i këtij programi është t’i pajisë studentët me njohuri themelore për formimin e tyre si specialistë në fushën të marrëdhënieve ndërkombëtare (të fokusuar në studimet rajonale pra në studimet evropiane dhe në studimet mesdhetare) si dhe për vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë).</i>




	<i>Evidenca 4 Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH fq.6</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit te Programit fq.2</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare” është hartuar në përputhje dhe në zbatim të Statutit të UMSH, Rregullores së Organizimit, të Planit strategjik për zhvillimin e institucionit dhe të strategjisë së zhvillimit të programit të studimit. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Emërtimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit është ndërtuar dhe bazohet mbi fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim zhvillimit të UMSH. Në hartimin e programit të ciklit të parë të studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare”, synohet të formohen studentët me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale nëpërmjet mësimdhënies, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare. <i>Evidenca 1 Statuti;</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH;</i> <i>Evidenca 4 Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH;</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit të Programit</i> <i>Evidenca 8 Rregullore e DSHPMN</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvijë, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UMSH është institucion jopublik i cili prej më shumë se 17 vitesh ushtron aktivitetin në fushën e arsimit të lartë. Ky institucion ka në përbërje katër fakultete si: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane; Fakulteti i Shkencave Ekonomike; Fakulteti i Informatikës; Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Programi bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. DSHPMN për vitin akademik 2023-2024 përbëhet nga 11 anëtar efektivë me tituj dhe grada si vijon: 1 Prof.dr, 2 Prof.as., 6 Dr dhe 2 Msc ndërsa stafi akademik me kontratë përbëhet nga 5 anëtar me tituj dhe grada si vijon: 4 Dr dhe 1 Msc. <i>Evidenca 53 Permbledhje e tabelave</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të	Programi bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. <i>Ky program është në harmoni me fushën e përgjithshme dhe specifike të njësisë bazë por jo me atë të njësisë kryesore. Bazuar në kategorizimin e ISCED, programi dhe njësia kryesore janë në nivele të ndryshme.</i> Programi është në përputhje dhe bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe akteve rregullatore të UMSH.

programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare” përputhet me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik të Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Njësia bazë është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat e nevojshme për të ofruar një program të tillë. Programi klasifikohet në nivelin 6 të kornizës kombëtare të kualifikimeve. Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënës, sistemit evropian të transferimit të krediteve dhe në harmoni me kuadrin ligjor vendas. <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH;</i> <i>Evidenca 8 Rregullore e DSHPMN</i>			
Konkluzione	<i>Përsa referuar më lart, institucioni i arsimit të lartë, i cili ofron programin e studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare”, përmbushur kriteret e vlerësimit dhe synon ruajtjen e interesave kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, etj. Në dokumentat ligjor institucional, janë të shprehura qartë misioni dhe vizioni i institucionit për programe studimi aplikative dhe inovatore. Referuar mospërputhjes së fushës së programit të studimit në Shkencë Sociale (Kategoria nr.3) me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane (miks i Kategorive nr. 2 + nr.4) sipas standardeve ndërkombëtare ISCED 2011, kërkohet reflektimin nga institucioni që të përmbushë si standardet ndërkombëtare ISCED, edhe legjislacionin shqiptar si VKM nr.288, datë 11.05.2022 dhe VKM nr.310, datë 11.05.2022.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së	Statuti, rregullorja e UMSH dhe aktet e brendshme përcaktojnë dhe dispijlojnë në mënyrë institucionale marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda tij. Në këto dokumente, janë të përcaktuara rolet dhe përgjegjësitë respektive të drejtuesit të njësisë bazë dhe njësisë kryesore, përgjegjësit e grupit mësimor/kërkimor apo koordinatorit të programit etj. Institucioni ka të përcaktuar dhe është e qartë ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Pësha kryesore për realizimin e programit të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Mirëditë

[Signature]

përgjegjësi përkatese dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	studimit mbahet nga njësi bazë që është Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, gjithashtu dhe njësitë e tjera përgjegjëse për cilësinë, karrierën apo etiken kanë rol në implementimin e programit. Departamenti ka hartuar rregullore për këtë program studimi. <i>Evidenca 1 Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMSH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	UMSH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe organizata të shoqërisë civile. Në vitin 2018, institucioni miratoi Planin strategjik të Zhvillimit për periudhën kohore 2018-2023 për të zhvilluar më shumë bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkim shkencor si dhe shumë njohjen dhe kooperimin me partnerët brenda dhe jashtë vendit. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përfiton nga marrëveshjet e bashkëpunimit të realizuara në nivel fakulteti, ashtu edhe në kuadër të marrëveshjeve të realizuara në nivel institucional. UMSH ka lidhur marrëveshje me 32 universitete jashtë vendit. Përfitimet nga këto marrëveshje janë në radhë të parë përmes bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimit të eksperiencave mes palëve. Ato krijojnë mundësi që studentët të zhvillojnë praktikat profesionale pranë këtyre institucioneve, si dhe japin mundësinë e shkëmbimit të stafëve akademike për shkëmbim eksperiencash me universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Evidenca 10 Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 4 Plani Strategjik i Zhvillimit</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatese për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Dokumentet themelore të Universitetit (Statuti, Rregullorja e Universitetit dhe Plani Strategjik 2018-2023 përcaktojnë synimet kryesore dhe objektivat që i korrespondojnë edhe ndërveprimit me institucione, kompani të fushavë përkatese dhe institutive kërkimore për realizimin e praktikave mësimore apo praktikave profesionale. Bazuar në Planin Strategjik 2018-2023 institucioni synon shtimin e kontakteve dhe bashkëpunimit me palët e treta, për të krijuar më shumë hapësira dhe mundësi për praktikë apo mobilitet për studentët dhe ura për lidhje midis të diplomuarve në UMSH dhe tregut të punës. <i>Evidenca 1 Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMSH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Evidenca 10 Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 4 Plani Strategjik i Zhvillimit</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse	Njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, harton në mënyrë të rregullt raporte vlerësuese dhe faktike mbi të dhënat e viteve akademike




për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	për punësimin, stazhet dhe diplomimin e studentëve si rrjedhojë e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Këto janë pjesë e raporteve vjetore të njësisë bazë. <i>Evidenca 10 Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimin në institucion, GVJ konkludon se njësitë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e programit sigurojnë marrëdhënie dhe kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtare dhe kombëtarë për realizimin sa më efektiv të këtij program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” është i organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) në total me 180 ECTS, i ndarë në 60 kredite për çdo vit akademik, në një hark kohor prej 3 vitesh. Programi i studimit reflekton qartë elementët e duhur të strukturës së një programi të studimi të ciklit të parë. Programi është në përputhje me kriteret e përcaktuar në VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar). <i>Evidenca Nr.13. Plani Mësimor Bsc MIN</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose	Ky program studimi përbën një përpjekje për të aftësuar studentët me dije, njohuri dhe ekspertizë të konsiderueshme profesionale e aplikative. Programi i studimit synon, nëpërmjet secilës lëndë, t’u japë studentëve terminologjinë e duhur që i duhet në formimin e tyre akademik e profesional që kombinon teorinë dhe praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare si në aspektin teorik dhe atë praktikë me

punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	modelet më të mira të analizave krahasuese dhe njohjen e organizatave ndërkombëtare etj. Në syllabusin e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxënit dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde. Aftësitë shprehimore teknike i lejojnë studentët për t'u përballur me specializimeve profesionale në punë të kualifikuara ku nevojiten njohuritë që lidhen me këtë program studimi. <i>Evidenca Nr.13. Plani Mësimor Bsc MIN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit ofrohet me 180 ECTS, në përputhje me planin mësimor. Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. - Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturre e përgjithshme (34 ECTS; 19%) - Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (91 ECTS; 51%) - Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. (27 ECTS; 15%) - Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. (20 ECTS; 11%) - Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës (8 ECTS; 4%) <i>Evidenca Nr.13. Plani Mësimor Bsc MIN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”, ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Konkretisht, praktika mësimore realizohet në vitin e tretë të studimeve në semestrin e dytë dhe ka 6 kredite, ndërsa provimi i formimit (detyrimet përmbyllëse) kanë 8 kredite. <i>Evidenca Nr.13. Plani Mësimor Bsc MIN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.

përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.				
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nga kërkimet e GVJ në internet rezulton se program me të njëjtën emërtesë Bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”, nuk e ofron ndonjë IAL-tjetër. Gjithashtu, bazuar në RVB cilësohet se ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Institucioni ka realizuar procesin e kodifikimit të programeve të studimit, dhe për këtë proces ka njoftuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kodifikimin kombëtar i tij është bazuar në nenin 86 dhe nenin 125, të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Programi i studimit MIN i është vendosur kodi 0312. Ky process pritet të finalizohet nga MAS. <i>RVB Marrëdhënie dhe Institucionet ndërkombetare</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore të institucionit. Programi i studimit të ciklit të parë, bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”, është i organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) në total me 180 ECTS. Programi i studimit synon që nëpërmjet trupës së lëndëve të planit mësimor t’u japë studentëve njohuri sa më koherente dhe gjithëpërfshirëse. Institucioni ka realizuar procesin e kodifikimit të programit të studimit i cili ka kodin 0312.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Alban

94

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Veprimtaria e Fakultetit dhe Departamentit bazohet në aktet rregullatore të Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e parashikuara në këto akte. Për organizimin e punës, krahas akteve në nivel institucional si Rregullore Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti, departamenti ka miratuar dhe një Rregullore të dedikuar për programin e studimit Master Shkencor në “Shkenca Politike” (<i>Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit BSC MIN</i>). Në këtë dokument janë të përcaktuara detajet dhe specifikimet e programit, qëllimet dhe objektivat e tij, mënyra e organizimit të studimeve, kontrolli i dijes, diplomimi, statusi i studentit etj. Ky departament përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën dhe stafet akademike. Përbërja e Departamentit paraqitet si në vijim: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2021 – 2022</th><th colspan="2">2022 – 2023</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>4</td><td>4</td><td>6</td><td>4</td><td>6</td><td>4</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>6</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Totali</td><td>11</td><td>5</td><td>11</td><td>5</td><td>11</td><td>5</td></tr></table> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Permbledhje e tabelave</i>	Tituj/ grada	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	-	1	-	1	-	Prof. Asoc.	-	-	2	-	2	-	Dr./PhD.	4	4	6	4	6	4	Msc.	6	1	2	1	2	1	Totali	11	5	11	5	11	5
Tituj/ grada	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr.	1	-	1	-	1	-																																											
Prof. Asoc.	-	-	2	-	2	-																																											
Dr./PhD.	4	4	6	4	6	4																																											
Msc.	6	1	2	1	2	1																																											
Totali	11	5	11	5	11	5																																											
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, sikurse edhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare kanë numrin e nevojshëm të personelit akademik dhe ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe kapacitetet për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i këtij programi studimor. Angazhimi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është përgjithësisht i përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit të studimit. Sipas																																																

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	programit mësimor “Praktika” realizohet në semestrin e II të vitit të 3 akademik dhe ka 6 kredite. Institucioni ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet ku zhvillohen praktikat mësimore. Nga bisedat me studentët, GVJ konfirmoi se Departamenti i drejtonte për realizimin e praktikës në institucionet publike, apo dhe pranë OSHC që operojnë në këtë fushë. Natyra e programit të studimit nuk kërkon aplikimin e praktikave laboratorike e klinike. <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Permbledhje e tabelave</i> <i>Evidenca 10 Lista e Marreveshjeve te bashkepunimit</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në aktet rregullatore të UMSH-së është përcaktuar pozicioni i Koordinatorit të fakultetit. Pozicioni i koordinatorit realizon bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet departamenteve, bashkëpunon me sekretarinë e fakultetit dhe ndihmon Dekanin për çështje të manaxhimit, si dhe është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale, duke koordinuar veprimtarinë ndërmjet njësive bazë dhe institucioneve publike e jopublike me të cilat institucioni ka marrëveshje. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Stafet akademike dhe ndihmës akademike janë të përshtatshëm në drejtim të arrijtes së objektivave të programit të studimit Pozicioni i koordinatorit realizon bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet departamenteve dhe është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e praktikavës mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit, takimeve gjatë vizitës në UMSH dhe dokumentave shtesë, grupi i ekspertëve të jashtëm thekson se programi bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe provim formimi të vlerësuara me kredite sipas Sistemit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	European të Transferimit të Krediteve (ECTS), të cilat zhvillohen në 3 vite akademik, të ndarë në dy semestra. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare kanë strukturën dhe kapacitetet akademike dhe administrative, dokumentacionin dhe teknikalitetet e nevojshme lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Informacioni dhe teknikalitetet janë të aksesueshme dhe ju vihen në dispozicion stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve që ndjekin këtë program studimi. Përgjegjësi i Departamentit mban komunikim dhe informon Dekanin e Fakultetit me zhvillimet që lidhen me punët e departamentit, studentët, anëtarët e stafit akademik dhe ndihmës akademik/administrative etj. <i>Evidenca 6. Rregullore e FDSHH.</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Evidenca 8 Rregullore DSHPMN</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bsc MIN</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për çdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Ky program studimi është i organizuar në 3 vite akademike (6 semestra) me një total kreditesh 180 ECTS. Çdo vit akademik përmban 60 ECTS me nëndarje të lëndëve të tipologjisë A, B, C, D dhe E. Gjuha e programit të studimit është shqip. Në rregulloren e institucionit, në rregulloren e programit të studimit si dhe në çdo syllabus përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimi dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bsc MIN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Institucioni ka të përcaktuara qartë kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve në programin e studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” të cilin mund ta ndjekin studentë shqiptarë si dhe nga trevat shqip-folëse që kanë kryer studimet e shkollës së mesme. Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit, përfshirë rregulloren e programit të studimit dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen nga një komision i veçantë pedagogësh duke marrë parasysh vit pas viti kriteret bazë të vendosura nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në




	programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të UMSH. <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Evidenca 31 Broshura e programeve Bachelor</i> https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” organizohet në lëndë (sipas kategorizimeve), praktikë dhe provim formimi të shprehura në kredite ECTS dhe të grupuara sipas komponentëve mësimorë formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Syllabuset e lëndëve që përmban plani mësimor është hartuar në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë të strukturuar sipas formatit të miratuar në nivel institucioni. Në to paraqitet informacion i detajuar në lidhje me objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të studiojë. <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Evidenca 13 Plan Mesimor Bsc MIN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Përmbajtja e programit të studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm nga DSHPMN. DSHPMN bën analizë të syllabuseve të të gjitha lëndëve të programit, sipas procedurave përkatëse dhe në kohë të mjaftueshme përpara fillimit të procesit mësimor. Rishikimi dhe përditësimi i lëndëve të ofruara në këtë program studimi realizohet nga lektorët përgjegjës të departamentit, dhe çdo silabus përditësohet dhe miratohet përpara fillimit të vitit akademik nga departamenti. Analiza e syllabusit merr parasysh të gjithë elementët e tij thelbësorë duke u ndalur në përputhjen e plotë të tij me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi, aktet rregullatore të miratuara nga UMSH si dhe kërkesat e tregut të punës. <i>Evidenca 13 Plan Mesimor Bsc MIN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit të studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” ka disa avantazhe të rëndësishme përse i përket thellimit të njohurive për studime të mëtejshme apo dhe për punësimin e studentëve. Ky program studimi, mënyra sesi është menduar kurikula dhe syllabuset, është mëse i përshtatshëm për të pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të vijuar më tej në programet e studimit Master i Shkencave të ofruara po nga UMSH, apo programe të tjera të ciklit të dytë me përmbajtje dhe disiplinë të njëjtë e të afërt. <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bsc MIN</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Shpërndarja e lëndëve në vite e semestra është në mbështetje të VKM 41/2018, (i ndryshuar), mbi klasifikimin e veprimtarive formuese në lëndët bazë, në lëndët karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse mundëson më së miri arritje dhe përmbyllje efikase të objektivave formuese të programit të studimit duke i aftësuar studentët në aftësi të transferueshme (si komunikimi publik, formulimi i argumenteve, ndërmarrja e një kërkimi studimor), apo edhe në njohuri që reflektojnë gjendjen e studimeve aktuale në disiplinën mbi të cilën është ngritur programi i studimit. Programi i studimit mbështetet në vlerësimin e larmishmërisë ndërdisiplinore që u mundëson studentëve të përftojnë nga perspektiva njohëse të përafërta nga disiplina kryesore e studimit. Ky program i mundëson studentët të zhvillojnë aftësitë krijuese, mendim kritik dhe ndërtimin e argumentave bazuar në fakte dhe analiza akademike. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bsc MIN</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” ka një strukturë të mirë lëndore dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në harmoni të plotë me atë çka kërkon një program i një niveli “bachelor” si në nivelin kombëtar dhe atë rajonal për studentët brenda dhe jashtë vendit. Syllabuset dhe plani mësimor përcaktojnë qartë dhe në mënyrë eksplicite emërtimi, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë të lëndës apo modulit. Shpërndarja e lëndëve realizohet përkatësisht në 6




	semestra të përgjatë 3 vite akademike, me një total prej 180 kreditesh në funksion të objektivave formuese të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit të studentëve. Praktika Profesionale ka 6 kredite dhe zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të 3-të, gjithashtu realizimit të detyrimeve përmbyllëse ka 8 kredite. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bsc MIN</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në përfundim të studimeve i shërben arritjes së objektivave të zhvillimit profesional dhe aftësimit për tregun e punës. Gjithashtu, programi mundëson transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve, (Neni 76 i Statutit UMSH) sikurse dhe punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve pasi programi i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme. Syllabuset e lëndëve në programin e studimit kanë rubrikën e kontrollit të dijeve të ndarë në: Detyra Kontrolli përgjatë semestrit 5 të tilla, Projekt kursi dhe provimin përfundimtar. Realizimi i të gjitha lëndëve, i praktikës dhe provimit të formimit e kompletton studentin me aftësi dhe kompetenca për të konkuruar denjësisht në tregun e punës. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit_BSc MIN</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bsc MIN</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Personeli akademik i Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përditëson në mënyrë të vazhdueshme programet e lëndëve duke përfshirë literaturën bazë më të fundit në disiplinën apo nëndisiplinën formuese të botuar nga shtëpitë botuese më të mira ndërkombëtare në lidhje me lëndët përkatëse të programit të studimit. Syllabuset janë në përputhje me vendimet ligjore duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Në mënyrë periodike, institucioni u kërkon pedagogëve përditësimin e syllabuseve. Ndërsa syllabuset përditësohen çdo vit, <i>pjesa e literaturës së syllabuseve kërkon vëmendje të veçantë, veçanërisht për sa i përket viteve të botimit të literaturës.</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje të plotë dhe garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij




	programi (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik).			
	<i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit_BSc MIN</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bsc MIN</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit dhe syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se ky program u ofron studentëve njohuri të specializuara dhe të thelluara në fushën e Shkencave Politike, Institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, marrëdhënieve ndërkombëtare, siç është i strukturuar programi, duke u dhënë mundësi studentëve të marrin baza për të vijuar me studime të mëtejshme, apo të shfrytëzojnë aksesin në tregun e punës. Programi i studimit, mbështetur edhe në fushën e veprimtarisë së institucionit, përgatit e aftëson profesionistë të marrëdhënieve dhe institucioneve ndërkombëtare të denjë për tu përfshirë në Institucionet publike, në organizata të shoqërisë civile dhe organizata e institucione ndërkombëtare, në shërbimin e jashtëm, në përfaqësimin e ekspertizës kombëtare në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE etj. <i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit_BSc MIN</i> <i>Evidenca 13 Plani Mesimor Bsc MIN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit bachelor në "Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare" është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve si dhe të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe realizohen me 180 kredite, i strukturuar në 6 semestra. Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar në Planin Mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascala.al

E-mail: info@ascala.al

Alina

Y

JG

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Institucioni ka një kuadër të plotë dokumentacioni si statut, rregullore, strategji, etj që orientojnë procesin e krijimit apo përmirësimit të përmbajtjes së programeve të studimit. Instrumentat dhe baza ligjore ku mbështetet funksionimi i departamentit e përcakton atë si njësi përgjegjëse për nisjen e procesit për realizimin e përmirësimit të përmbajtjes së programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Institucioni bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve të tij nënligjore si dhe ka infrastrukturën dhe strukturat përgjegjëse që të asistojnë departamentin për ndërmarrjen e një procesi të tillë. Raportet dhe analizat periodike që realizojnë njësitë e garantimit të cilësisë dhe sigurisë së mësimdhënies shërbejnë gjithashtu për këtë proces. GVJ vlerëson se marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private i kanë mundësuar departamentit të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca që krijohen dhe ndryshojnë herë pas here. Departamenti organizon në kuadrin e aktiviteteve institucionale aktivitete të përbashkëta me partnerët si lektorë të ftuar, apo me përfaqësues të pushtetit qendror. <i>Evidenca 4_ Plani Strategjik i Zhvillimit</i> <i>Evidenca 14_ Analize e tregut te punes</i> <i>Evidenca 10_ Lista e Marreveshjeve te bashkepunimit</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	GVJ bazuar në takimet e realizuara me stafin e departamentit, zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe asaj të Sigurimit të Cilësisë, si dhe opinionin e studentëve rezulton se institucioni i konsideron një burim të rëndësishëm informacioni për përmirësimin e programit vlerësimin e studentëve për programin e studimit. Njësia e Cilësisë (NJSBCZHK) dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ka në fokus marrjen e opinionëve të studentëve në lidhje me zhvillimin e programit dhe procesit mësimor. Zyra e Alumnit e institucionit mban kontakte me studentët e diplomuar përmes aktiviteteve periodike dhe përcjell propozimet në njësinë bazë DSHPMN. https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata,	Përmes përshtatjes dhe ndryshimeve që ka ndërmarr për të rishikuar programin e studimit dhe për tju përgjigjur kërkesave dhe tregut të punës, UMSH ka dëshmuar se ka infrastrukturën dhe mekanizmat e bashkëpunimit me rrjete e institucione publike e private për të marrë feedback që lidhet me nevojat për të përshtatur programet e studimit në përputhje me propozimet e ardhura prej tyre. DSHPMN ka kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore që t'i përgjigjet kërkesave dhe nevojave për zhvillimin e programit të studimit dhe përshtatjen e programit




urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	kundrejt nevojave nga institucionet publike e private në nivel qendror e lokal, në fushat e ekspertizës që mbulon ky program.			
Konkluzione	<i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit BSc MIN</i> <i>Institucioni ka infrastrukturën dhe bazën ligjore për përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Institucioni merr masa për realizimin me sukses dhe në përputhje me objektivat e përcaktuara në aktet rregullatore të tij. Në shqyrtimin e dokumentacionit dhe bisedat me drejtuesin e departamentit dhe studentët konfirmohen marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private, të cilat i kanë mundësuar departamentit të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca dhe aftësi bashkëkohore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për realizimin e programit të studimit, staf i akademik i DSHPMN integron dhe harmonizonë metodat bashkëkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive (vizita në institucion). Rregullorja e programit të studimit dhe programet lëndore parashikojnë se gjatë mësimdhënies përfshihen të gjithë elementët formues në funksion të studentit si: leksionet, seminarët, ushtrimet, projektet dhe detyrat e kursit, praktika mësimore, provimi I formimit, gjithashtu here pas here u ofrohet studentëve edhe leksione të hapura me personalitete të ftuar. (neni 7 i rregullores së Bcs MIN) <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,	GVJ gjatë vizitës në institucion, u njoh me këndvështrimin e studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit për procesin e mësimdhënies. Zhvillimi i orëve të leksionit realizohet përmes aplikimit të metodave interaktive, punëve individuale, diskutimeve dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Alina

[Signature]

mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	herë pas here ekspertëve të ftuar. Diskutimet në orën e seminarit dhe prezantimet i japin mundësi studentit të bëjë analiza dhe të shprehë mendimin e tij në mënyrë të pavarur. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Institucioni zhvillon një filozofi mbështetëse ndaj rritjes akademike dhe strukturat e tij përkrahin zhvillimin e metodave të suksesshme mësimore për stafin akademik. UMSH ka mundur trajnime për stafin akademik me qëllim rritjen e kapaciteteve. Institucioni mbështet financiarisht stafin akademik duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimuljeve për përmirësimin profesional. Në kuadër të marrëdhënieve dhe marrëveshjeve të UMSH me shumë IAL vendase dhe të huaja, stafi ka hapësira për kualifikim të vazhdueshëm, në kuadër të organizimit, mbështetjes dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore, botimeve në revista, vizitave studimore, mobiliteteve, pjesëmarrjeve në leksione të hapura, etj. Personeli akademik i programit të studimit ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh në universitetet partnere evropiane si Greqi e Gjermani, apo përmes programeve të shkëmbit Erasmus+ personeli akademik ka patur mundësi të japë mësim dhe të përfitojë eksperiencë në universitetet partnere. <i>Evidenca 32 Levizjet e stafit</i> <i>Evidenca 25 Program i trajnimeve</i> <i>Evidenca 4 Plani Strategjik i Zhvillimit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Stafi akademik i departamentit është me përvojë në mësimdhënie dhe ka kualifikime shkencore që e bëjnë kompetent për modulet që zhvillon në dhënien e njohurive në kuadër të këtij programi studimi. Bazuar në Rregulloren e programit të studimit dhe infrastrukturën që ka institucioni, stafi akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin përmes nxitjes së mendimit krijues dhe zhvillimit të përgjithshëm të tij. Pedagogët përpiqen që të ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi me studentët duke i përfshirë në aktivitete akademike dhe shkencore <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë	Institucioni ka ndërtuar praktika periodike vlerësimi në nivele të ndryshme me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe ruajtjen e cilësisë. Bazuar në aktet rregullatore bazë të UMSH, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton në mënyrë periodike dokumentin me titull “Planveprimi 2023-2024 UMSH”.




periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	<i>NJSBCZHK në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe njësitë bazë, në fund të çdo semestri organizojnë dhe plotësojnë pyetësorin për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. Gjithashtu dhe fokus-grupet janë një tjetër instrument që përdoret për të marrë mendimet e studentëve. Rezultatet e këtyre pyetësorëve bëhen pjesë e raporteve që NJSBCZHK përgatit, i shpërndan në departamente dhe fakultete dhe i paraqet në rektorat.</i> <i>Evidenca 33_ Plani i Punës NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 49_ Rregullore për organizimin NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 29_ Procedurat e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca 27_ Formulari i Vleresimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Procesi i monitorimit të programit të studimit realizohet si në nivel institucional (<i>NJSBCZHK</i>), njësi kryesore dhe atë bazë. Në bazë të Statutit (kreu XI; Neni 84, Neni 85) dhe Rregullores së njësisë, <i>NJSBCZHK</i> (Neni 1; Neni 2) operon në nivel institucional si strukturë që monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të stafit akademik dhe realizimit të programeve të studimit. Njësia përbëhet nga 9 anëtar dhe ka autonomi vepruese dhe akses për të gjitha të dhënat e institucionit (Neni 3). Kjo zyrë ka kompetencë të hartojë raportet e vlerësimit të pyetësorëve të realizuar nëpërmjet njësive bazë dhe atyre kryesore, të cilët i paraqet Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe vë në dijeni drejtuesit e njësive kryesore (Neni 9 i Rregullores së sipërcituar). Kjo njësi bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me njësitë kryesore dhe bazë dhe organizojnë trajnime për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Kujdes i veçantë i kushtohet trajnimit të personelit akademik të angazhuar rishtazi, sikurse u konfirmua gjatë takimit të GVJ me stafin akademik duke vënë theksin në aspektet metodike dhe të organizimit të procesit mësimor. <i>Evidenca 16 Rregullore e organizimit dhe punës NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 25_ Programi i Trajnimeve.</i> <i>Evidenca 33_ Plani i Punës NJSBCZHK</i>
Konkluzione	<i>Për garantimin dhe ruajtjen e cilësisë së programeve të studimit, strukturat respektive realizojnë disa forma vlerësimi, si për studentët, stafet apo edhe vetëvlerësimi për të matur progresin e bërë në drejtim të formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies. UMSH ka struktura institucionale që mbështesin përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, në veçanti NJSBCZHK. NJSBCZHK dhe njësia bazë mbledhin opinione, duke përfshirë studentët në këtë proces përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve.</i>

	Institucioni mundëson trajnime për stafin akademik në drejtim të metodikave të mësimdhënies, inovacionit në fusha të ndryshme, njohjen e kuadrit rregullator të arsimit të lartë etj. Institucioni përmes stafit akademik dhe infrastrukturës mbështetëse harmonizon dhe garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve, njohurive, si dhe kriteret dhe komponentët e vlerësimit pasyrohen në rregulloren e programit të studimit si dhe në plan programet e çdo lënde. Dija e studentit kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu dhe në forma të ndryshme. Studentët njoftohen mbi këtë gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Çdo syllabus ka një seksion të veçantë për mënyrën e vlerësimit të lëndës. Pjesëmarrja në leksione është e detyruar në masën 75%. Testimi dhe vlerësimi i njohurive përbëhet nga dy rubrika: vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim përfundimtar. Në plan programet e çdo lënde (në masën më të madhe të tyre) përcaktohet e kategorizuar dhe pikëzuar si vijon: Komponentët e vlerësimit - Detyrë Kontrolli 10 % - Detyrë Kontrolli 10 % - Detyrë Kontrolli 10 % - Detyrë Kontrolli 10 % - Detyrë Kontrolli 10 % - Detyra/Projekte kursi 20 % - Provimi përfundimtar: 30 %. - Totali 100 %. Shënim: ka syllabuse ku komponentët e vlerësimit kanë pikëzime të ndryshme si psh: lenda “Institucione ndërkombëtare financiare” vlerësim i vazhdueshëm 15%; detyrë kursi/vlerësim i vazhdueshëm 15%; provim i ndërmjetëm 30 % dhe provimi përfundimtar 40%. Kjo përputhet me parimin e autonomies së stafit akademik që të përshtas komponentët e vlerësimit sipas rëndësisë që lektori i lëndës gjykon. Vlerësimi me notë realizohet nga 4(katër) deri në 10(dhjetë).




	<i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i> <i>Evidenca 20_ Udhezues per studentet</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo semestër, titullari i lëndës i njeh studentët me syllabusin e lëndës që do të zhvillohet përgjatë tij. Gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit pedagogu sqaron strukturën lëndore dhe komponentët e syllabusit në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe takimin me studentët konfirmoi se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përdor format e kontrollit të dijes së vazhdueshme përgjatë gjithë realizimit të lëndës duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Përgatitja e vazhdueshme shikohet në detyrat e kontrollit; projektet; testimi me shkrim etj. Provimi me shkrim është një komponent i rëndësishëm i vlerësimit krahas komponentëve të tjerë plotësues si pjesëmarrja, detyrat e kontrollit, detyra e kursit/projektet. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i> <i>Evidenca 21_ Udhezim mbi procedurat dhe afatet e sezonit te provimeve</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Stafi akademik i njësive bazë i angazhuar në këtë program studimi përdor metoda mësimdhënie interaktive ku synon përfshirjen sa më shumë të studentëve në procesin mësimor. Vlerësimi i aftësive të stafit akademik me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve, bëhet edhe nga studentët. Institucioni zhvillon praktika periodike vlerësimi në nivele të ndryshme me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe ruajtjen e cilësisë. Bazuar në aktet rregullative bazë të UMSH, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton në mënyrë periodike dokumentin me titull “Planveprimi 2023-2024 UMSH”. <i>NJSBCZHK</i> në bashkëpunim me njësitet kryesore dhe njësitet bazë, në fund të çdo semestri organizojnë dhe plotësojnë pyetësorin për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. Gjithashtu dhe fokus-grupet janë një tjetër instrument që përdoret për të marrë mendimet e studentëve. Rezultatet e këtyre pyetësorëve bëhen pjesë e raporteve që <i>NJSBCZHK</i> përgatit, i shpërndan në departamente dhe fakultete dhe i paraqet në rektorat. <i>Evidenca 33_ Plani i Punes NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 23_ Formular i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i>




	<i>Vizita në institucion</i>			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik dhe ndihmës pranë njësisë bazë janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Ky proces udhëhiqet nga Drejtuesi i Departamentit dhe monitorohet dhe vlerësohet me kujdes nga vlerësimet periodike të tilla si vlerësimet e studentëve dhe vlerësimet e pedagogëve. Qëllimi është të sigurojë reagime konkrete dhe të prekshme mbi masat që duhen marrë për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kurrikula është krijuar për të mundësuar një kombinim të ekuilibruar midis metodave të mësimi teorik me atë praktik.			
Konkluzione	UMSH ka hartuar rregullore dhe procedura të testimit e vlerësimit të njohurive në mënyrë të vazhdueshme duke gërrshetur punën përgjatë kursit me testimet përfundimtare. Zbatimi i procedurave të testimit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore garantohen nga stafi akademik dhe strukturat përgjegjëse që ka institucioni. Studentët njoftohen gjatë javës së parë të fillimit të studimeve nga pedagogu përkatës mbi komponentët e syllabusit dhe mënyrën e detajuar të kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve. Format e vlerësimit janë të përshkruara edhe në syllabuset e lëndëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	UMSH ka një strukturë që përvijon kontrollin e vazhdueshëm të dijes gjatë vitit. Kjo reflektohet kryesisht në ndarjen e angazhimit dhe përfshirjen e studentëve në diskutime gjatë seminareve me detyra kontrolli përgjatë zhvillimit të lëndës, detyrave të kursit/projektet dhe provimit të kontrollit të dijes përfundimtare. Bazuar në Rregulloren e Departamentit në nenin 18 “Kontrolli i Dijes” thuhet se “Forma kryesore e kontrollit të dijes është provimi. Provimi mund të bëhet: a) me shkrim b) me gojë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Mirë

24

	c) i kombinuar, e shkrim dhe gojë Rregullorja përcakton gjithashtu parimet e kriterëve të vlerësimit për kursin, si edhe tabelën e vlerësimit të notave. Pavarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, tesimi i njohurive bëhet gjatë të gjithë kursit duke u bazuar mbi elementë të ndryshëm siç janë pjesëmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve, testimi me shkrim/gojë apo i kombinuar. Kjo shihet në shpërndarjen e vlerësimit përfundimtar në disa zëra dhe peshën e vlerësimit që ka secili komponent, përcaktuar qartë në rregulloren e programit dhe syllabuseve duke u harmonizuar me kërkesat e lëndës. <i>Evidenca 8_Rregullore DSHPMN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UMSH ka mbështetur përdorimin e sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit, në përputhje me mundësitë e aplikimit të tyre në programet e studimit me qëllim sigurimin e origjinalitetit të përgjigjeve dhe transparencës së vlerësimit. Institucioni ka nxitur pedagogët të vënë në zbatim formatet elektronike (quiz assignment) google form, të testimit dhe vlerësimit të provimeve, duke ofruar trajnime dhe udhëzues të posçëm. Disa prej tyre vazhdojnë të përdoren dhe që lidhen me vlerësimin e vazhdueshëm në platformën google classroom. <i>Evidenca 30_Manual i përdorimit të SMS</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bazohet në vlerësimin e të mësuarit të studentit përgjatë gjithë kursit, e shprehur në komponentët e cituar me sipër, duke bërë një përlllogaritje të pikëve dhe përqindjes respektive të secilit prej tyre. Vlerësimi del në përputhje me rregulloren e UMSH. Komponentët e vlerësimit me pikët dhe përqindjen përkatëse përbëjnë një seksion të veçantë në syllabusin e lëndës, i cili ju shpjegohet studentëve në orët e para të fillimit të lëndës. Kjo mënyrë vlerësimi është parashikuar në statut, rregulloren e UMSH. Procedurat e vlerësimit përfundimtar të njohurive bëhet nga titullari i lëndës sipas përcaktimeve në aktet rregullative të institucionit dhe departamentit. Procesverbali final mban firmën e pedagogut, shefit të departamentit, kryesekretares dhe dekanit. <i>Evidenca 8_Rregullore DSHPMN</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bazohet në vlerësimin e të mësuarit të studentit përgjatë gjithë kursit. Aktet rregullative të institucionit përcaktojnë që tezat e provimit të kenë një seksion të veçantë ku pedagogu mund të bëjë komente për secilën pyetje. Sikundër dhe gjatë vlerësimit të komponentëve të ndryshëm të syllabusit si prezantimi i detyrave të kontrollit, projekteve etj pedagogu bën komentet përkatëse

nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	me fokus rrijten përmbajtësore të njohurive dhe aktivizimin e studentëve. Pedagogu i lëndës i komunikon studentit në javën e fundit të semestrit nivelin e pikëve të vlerësimit të vazhduar të fituara gjatë semestrit. Në kuadrin e vlerësimit të vazhduar çdo komponent i vlerësimit të njohurive argumentohet nga ana e stafit akademik dhe për këtë njoftohet studenti. Në korrigjimin që i bëhet tezave të provimit pedagogu komenton dhe evidenton të gjitha plotësimet/mos plotësimet që lidhen me trajtimin e tezës. <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 8_ Rregullore DSHPMN</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Kuadri rregullativ i institucionit në të gjitha nivelet përcaktojnë që kopjimi dhe plagjatura nuk tolerohet. Studentët njoftohen gjithashtu përmes Udhëzuesit për penalizimin në rast të konstatimeve të plagjaturës në detyrat e kursit apo punimet e diplomes. Akti do të konsiderohet thyerje e kodit të etikës dhe vlerësimi është automatikisht nota 4-tër. Procesi i provimeve monitorohen nga të paktën dy pedagogë, të cilët caktohen nga departamenti. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur. Po ashtu bëhen përpjekje për të shmangur plagjiaturën kur studentët dorëzojnë projekte, ese ose teza. <i>Edhe pse ky është një program bachelor dhe detyrimet përmbyllëse realizohen me provim formimi jo me punim diplome, nevojitet që institucioni të ketë në fokus marrjen e një programi elektronik anti-plagjaturë që mund të shërbejë për të vlerësuar origjinalitetin e projekteve apo eseve të dorëzuar prej studentëve të këtij programi.</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 20_ Udhëzues për studentet</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin respektiv dhe vizitën në institucion, GVI konfirmon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë. Procesi i sekretimit të provimit garanton vlerësimin objektiv të njohurive të studentit bazuar në punën e tij; korrigjimi i provimit bëhet nga pedagogët e lëndës nën drejtimin e titullarit të lëndës. Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Studentit (SMS), pedagogu hedh në procesverbalin analitik (online) pikët sipas komponentëve përkatës, brenda pesë ditëve nga zhvillimi i provimit, pas korrigjimit të provimit. <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në	Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar dhe transparente përsa i takon njohjes së studentëve me rezultatet e kontrollit të dijes. Rezultati paraprak i provimit i bëhet i ditur në kohë reale studentëve nëpërmjet sistemit SMS në llogarinë personale të tyre. Pas ditës së pestë të zhvillimit të provimit, organizohen seancat sqaruese me studentët dhe

përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	komisionin e vlerësimit para hartimit të procesverbalit përfundimtar. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të provimit, nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim, që dorëzohet në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe ndiqet nga njësia përgjegjëse. Pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve përfundimtare të provimeve. <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 8_ Rregullore DSHPMN</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën. Në aktet rregullatore të institucionit është e parashikuar procedura e ankimit ku parashikohen hapat që ndjek studenti për ri-vlerësimin e provimit. Kjo procedurë vlerësohet nga një komision i ngritur posaçërisht. Ky komision në bazë të kërkesës procedon me ballafaqimin e provimit e përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH</i> <i>Vizita në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka përcaktuar në aktet rregullative procedura që sigurojnë vlerësim të drejtë dhe transparent. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Rezultati paraprak i provimit i bëhet i ditur studentëve nëpërmjet sistemit SMS në llogarinë personale në kohë reale. Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit përkatës përmes një ankese me shkrim, e cila ndiqet nga njësia përgjegjëse. Këto informacione u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Në rregulloren e programit të studimit bachelor në MIN (neni 4 Objektivat formues të këtij programi) janë përcaktuar qartë objektivat e këtij programi studimi, të cilat synojnë të pajisin studentët me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për ti përdorur në karrierë profesionale. Gjithashtu synohet që përmes lëndëve karakterizuese dhe atyre me zgjedhje student të pajiset me njohuri të thelluara dhe plotësuese sipas profileve respektive. Programi ofron njohuri të përgjithshme dhe specifike, të mbështetura në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, si edhe plotësuese. Programi i studimit i lejon studentit që të krijojë profilin e tij akademik dhe profesional duke i dhënë mundësi për studime të thelluara në pas përfundimit të këtij cikli studimesh në fusha të ngjashme. Stafi akademik i departamentit krijon mundësi që kurrikula e programit të zhvillohet në standarde të larta me fokus formimin e studentëve duke konsideruar edhe nevojat e tregut të punës. Në kuadër të programit të studimit studentët angazhohen në aktivitete të ndryshme kërkimore dhe shkencore që i përgatit ata të thellojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre. Përmirësimi i vazhdueshëm i lëndëve me literaturën dhe me format bashkëkohore të mësimdhënies garanton përfitimin e njohurive duke gërshetuar analizat konceptuale në fushën e studimit me formimin kërkimor të përgjithshëm në përputhje me kërkesat e programit të studimit. <i>Evidenca 14_ Analize e tregut te punes</i> <i>Evidenca 13_ Plani Mesimor Bsc MIN</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Në programin e studimit bachelor në Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare zhvillohen lëndë të cilat mundësojnë dhe garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit si “Informatik”, humane si “Sociologji”; “Ekonomiks 1&2” etj. Kurrikula është e organizuar në mënyrë të tillë që të aftësojnë studentin dhe në drejtime të tjera përtej fushës së Marrëdhënieve dhe institucioneve ndërkombëtare, por të ndërlidhur me të. <i>Evidenca 13_ Plani Mesimor Bsc MIN</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton	Personeli akademik është përgjegjës për realizimin e programit lëndor dhe për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Pedagogët kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime ofrohen sugjerimet përkatëse për përmirësimin e punës me studentët. Forma e testimit të vazhdueshëm që bëhet për çdo lëndë mundëson vlerësimin e kompetencave dhe aftësive që merr studenti hap pas hapi përgjatë vitit akademik. Në përfundim të lëndës pedagogët bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara. Njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studenti gjatë vitit akademik




studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	analizohen përgjatë gjithë semestrit nga pedagogu dhe në përfundimin e lëndës jepet vlersimi i përmblendhur në të gjithë komponentët e tij. <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Rregulloret ku mbështetet funksionimi i departamentit dhe puna e stafit akademik për realizimin e programeve të studimit është e plotë dhe me kërkesa të larta në drejtim të cilësisë së mësimdhënies. Departamenti ka hartuar dokumentin <i>Strategjia e zhvillimit të Programit bachelor në MIN, i cili shërben për orientimin e punës dhe synimeve të të ardhmes</i>. Në lidhje me realizimin e procesit të mësimdhënies stafi akademik në aspektin teorik i ndihmon studentët të përfitojnë nga leksionet, materialet shtesë, literaturën e rekomanduar, apo raste studimore që mund të trajtohen në varësi të lëndës. Përfshirja e praktikës është gjithashtu një komponent i rëndësishëm për gërshetimin e njohurive me praktikën. UMSH ka traditë zhvillimin e leksioneve të hapura me personalitete politike dhe konferencave shkencore mbi strategjitë e zhvillimit të vendit. <i>Evidenca 19 Leksione të hapura DPSHPMN.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Institucioni ka një praktikë të mirë organizuar lidhur me aktivitetet ekstrakurrikulare që organizohen nga stafi akademik dhe staf të ftuar. Me angazhimin e personelit akademik të departamentit dhe në bashkëpunim me departamentet e tjera të UMSH, hartohet plani i aktiviteteve/ leksioneve të hapura. Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura për të informuar kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit të disiplinave dhe fushave të tyre të studimit. Institucioni organizon konferenca shkencore dhe aktivitete jashtë kurrikulare të cilat janë të hapura për studentët. Një praktikë pozitive është dhe përfshirja e personaliteteve të ftuar për të mbajtur leksione të hapura për çështje bashkëkohore që prekin jetën e vendit dhe tema me interes për studentët. <i>Evidenca 19 Leksione të hapura DPSHPMN.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, praktikave profesionale. Institucioni ka struktura e mekanizma në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Detyrimet përmbyllëse në programin e studimit bachelor në Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare realizohen me provim formimi. Për këtë qëllim stafi përgatit një program me pyetje orientuese i cili depozitohet në departament dhe bibliotekë. Udhëzuesi i provimit të formimit vendoset tek këndi i njoftimeve të UMSH-së. Sekretaria mësimore njofton studentët mbi procedurën dhe gjithashtu përmes faqes zyrtare të institucionit. <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Evidenca 17 _ Pyetjet orientuese</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar rregullores së Universitetit, strukturat përgjegjëse, stafi akademik dhe kryesisht sekretarët mësimore, ndihmojnë studentët që të mbyllin brenda afateve të përcaktuara dhe pa vështirësi, të gjitha detyrimet akademike, përmes informacioneve dhe udhëzimeve përkatëse. Drejtuesi i Departamentit, stafi akademik dhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet, afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Në rregulloren e programit të studimit, neni 23, përcaktohet procedura që lidhet me provimin e formimit. Në kuadër të detyrimeve përmbyllëse për studentët organizohen seanca këshëllimore dhe konsultime për grup-lëndët në të gjitha sezonet e provimit të formimit. <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN</i> <i>Evidenca 17 _ Pyetjet orientuese</i> <i>Evidenca 21 _ Udhëzim mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve RVB</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Tezat e provimit të formimit përgatiten nga komisionet e ngritura me udhër të dekanit në përputhje me Udhëzimin e Rektorit për provimin e formimit dhe formatet përkatëse. Programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës me tematika nga fushat kryesore të programit të studimit. <i>Evidenca 21 _ Udhëzim mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve</i>

Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Ky program studimi detyrimet përmbyllëse i ka me provim formimi. Departamenti propozon komisionet të cilat duhet të jenë me jo më pak se tre anëtarë nga departamenti. Komisioni miratohet nga Dekani i Fakultetit. <i>Evidenca 21 _ Udhezim mbi procedurat dhe afatet e sezonit te provimeve</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Stafi akademik i departamenti, punonjësit e bibliotekës dhe sekretaria mësiore asistojnë studentët në procesin e punës për plotësimin e detyrimeve përmblledhëse. Institucioni krijon kushte të përshtatshme për mbështetjen e studentit me materialet e nevojshme për punën e tij përgatitore në lidhje me përgatitjen për provimin e formimit.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të formimit studentit vlerësohet me notë. Sistemi i pikëzimit është i përcaktuar në nenin 18 të rregullores së DSHPMN. Sistemi i vlerësimit të studentit është prej dhjetë notash. Notat nga 0 deri në 4 janë nota jo kaluese, notat nga pesë e lartë janë kaluese. <i>Evidenca 21 _ Udhezim mbi procedurat dhe afatet e sezonit te provimeve</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Diploma, shoqëruar me suplementin është hapi i fundit. Studenti, që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur provimin e formimit pajiset nga UMSH me Diplomën përkatëse, e cila shoqërohet me suplementin e diplomës. Diploma nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit pjesë e të cilit është dhe departamenti që ofron programin e studimit dhe Rektori i UMSH-së. Në përfundim të studimeve, sipas kërkesë së studentit, studentit i vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. Procedurat e lëshimit të diplomës përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit. <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Krahas Rregullores së institucionit, njërive kryesore dhe atyre bazë, ka dhe një rregullore dedikuar punës dhe detyrave të sekretarisë mësimore. Studentët pajisen me dokumentat përkatëse sikurse parashikon ligji. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve dhe siguron mbrojtjen e tyre sipas legjislacionit në fuqi. Pas mbylljes së studimeve, dosja e studentit arkivohet dhe UMSH ruan kopje të

Mirza

[Signature]

	dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi dhe rast pas rasti ia ofron ato studentit nëse ai i kërkon.			
	Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN Evidenca 45 Rregullore e Sekretarisë Mësimore			
Konkluzione	Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbysllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga stafi i departamenti dhe struktura të tjera brenda institucionit. Në përfundim të studimeve, UMSH e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë diplomën edhe suplementin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me	GVJ konstaton se fakulteti dhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim të përshtatshëm burimesh njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Nga analiza e dokumentacionit, tabelave shoqëruese të RVB, GVJ konstaton se përmbushen kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Për 3 vitet e fundit akademik, përbërja e stafit akademik është si më poshtë: - 2021-2022, 8 PAE (1 Prof. Dr., 5 Dr., 2 Msc) dhe 1 PAK (1 Dr.); - 2022-2023, 14 PAE (2 Prof. Dr., 1 Prof. As., 8 Dr., 3 Msc) dhe 2 PAK (1 Dr., 1 Msc);

Mirëditë

[Signature]

programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	- 2023-2024, 16 PAE (2 Prof. Dr., 1 Prof. As., 9 Dr., 4 Msc) dhe 3 PAK (2 Dr., 1 Msc). <i>Evidenca Nr 53: Permbledhese e tabelave per programin;</i> <i>Evidenca Nr 13.3: CV e stafit akademik ne programin e studimit;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në evidencën tabelat përmbledhëse për tre vitet akademike e fundit, GVJ konsaton që ngarkesa mësimore është realizuar në masën mbi 90 % nga personeli akademik efektiv (PAE), nw pwrputhje me aktet ligjore në fuqi. <i>Evidenca Nr 53: Permbledhese e tabelave per programin,</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga analiza e tabelave shoqëruese të RVB, por edhe nga takime në institucion me stafin akademik dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore, vihet re një qëndrueshmëri i qartë dhe e lavdërueshme e stafit akademik përfshirë edhe atë PAK. Nga takimi në zyrën e personelit vumë re që dosjet e personelit ishin të plota dhe që, nga përzgjedhja rastërore, stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi kishte kontrata të rregullta sipas kriterëve ligjore në fuqi. <i>Evidenca Nr 53: Permbledhese e tabelave per programin,</i> <i>Evidenca Nr 13.3: CV e stafit akademik ne programin e studimit;</i> <i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion;</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi se procedura e rekrutimit është e mirë-rregulluar dhe e njohur për të gjithë aktorët e institucionit. Kjo procedurë fillon me konstatimin e vakancave nga njësia bazë e cila harton kërkesë për rekrutim stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Në këtë kërkesë, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret specifike për përzgjedhjen e kadidaturave, të cilat variojnë sipas nevojave të programit të studimit. Kriteret i përcillen zyrës së burimeve njerëzore të cilat pasi përpunohen i përcillen rektorit i cili i miraton. Shpallja e vakancave publikohet në faqen web të institucionit, në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë kur është e nevojshme. Për përzgjedhjen, rektori ngre një komision të kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit me dy faza. Faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të aplikimeve që janë dorëuar, ndërsa faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi i cila i përcillet rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi i rektorit. <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 1_ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 34_ Permbledhje e procedurës se rekrutimit.pdf</i> <i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion;</i>

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në analizën e GVB, DVV dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, siç u shprehëm edhe më sipër, ka angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi. Këto burime njerëzore përmbushin kriteret ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Specifikisht, për këtë program studimi, nuk ka nevojë për personel ndihmës akademik për orë laboratorike. <i>Evidenca Nr 53: Permbledhese e tabelave per programin, Evidenca Nr 13.3: CV e stafit akademik ne programin e studimit; Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion;</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi dhe në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. GVJ nuk evidentoi mangësi në dosjet e personelit akademik. <i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion; Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf Evidenca 1_ Statuti UMSH.pdf</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ka një sërë marrëveshesh me aktorë të tregut të punës që mundësojnë praktika të qenësishme dhe punësim potencial pas diplomimit. Praktika ndiqet nga një pedagog i dedikuar (pasi konsiderohet si lëndë me kredite specifike) i cili bashkëpunon me pikën e kontaktit në kompaninë pritëse. Në fund praktika vlerësohet me notë nga pedagogu dhe kompania pritëse. Bazuar në Dosjen e Praktikës, Zyrës së Keshillimit të Karrierës ka në kompetencat e saj parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënien e informacionit dhe asistencës së nevojshme për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/internshipeve të ofruara nga institucionet partnere. <i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion; Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf Evidenca 44_ Udhezues per Praktikant dhe formularet e praktikës.pdf</i>

	<i>Evidenca 10_ Lista e Marreveshjeve te bashkepunimit.pdf</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe sipas Dosjes së praktikave profesionale drejtuesit e bizneseve, japin udhëzime me vlerë për studentët në kuadër të praktikës profesionale, bëjnë rekomandime dhe vlerësime, duke plotësuar formularët e dërguar nga ana e UMSH për ndjekjen e zhvillimin e praktikës nga studentët. Gjatë gjithë kohës së praktikës, pedagogu që mbulon praktikën mban kontakte të vazhdueshme me të gjitha pikat e kontaktit në kompanitë pritëse për t'u informuar mbi vijimin e punës dhe për të adresuar problematika që mund të lindin gjatë praktikës. <i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion;</i> <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 44_ Udhëzues për Praktikant dhe formularët e praktikës.pdf</i> <i>Evidenca 10_ Lista e Marreveshjeve te bashkepunimit.pdf</i>			
Konkluzione	GVJ konstatoi se procedura e rekrutimit është e mirë-rregulluar dhe e njohur për të gjithë aktorët e institucionit. Fakulteti dhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim të përshtatshëm burimesh njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh me aktorë të tregut të punës që mundësojnë praktika të qenësishme dhe punësim potencial pas diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe vizitës së ambjentëve mësimore, GVJ konstatoi se kushtet infrastrukturale i mundësojnë personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ kryerjen me efektivitet të detyrave të tyre. Mjediset e IAL gjenden në një vendndodhje qendrore në Tiranë e janë lehtësisht të aksesueshme. Zyrat e pedagogëve dhe stafit administrativ ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të nevojshme. Po aq e rëndësishme, ambientet e IAL mbuloheshin nga me wireless që ofronte internet për stafin dhe studentët. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca 24_ Relacion i verifikimit te godines.pdf</i> <i>Evidencë 53: Permbledhje e tabelave.pdf</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Alina

[Signature]

Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. UMSH zotëron 5 laboratorë informatike të pajisur me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore për lëndë të këtij profili. Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me tabela whiteboard, videoprojektor, sistem fonie, internet etj. Sallat kanë hapësirë e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Ambjentet janë të pajisura me banka dhe karrige komode për t'ju përgjigjur edhe qëndrimit me orë të zgjatura në leksione dhe seminare të studentëve. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca 24_ Relacion i verifikimit te godines.pdf</i> <i>Evidencë 53: Permblendhje e tabelave.pdf</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ konstatoi se institucioni ka laboratorë të pajisur me programe profesionale në përputhje me tipologjinë e programeve të studimit që ofron. Shfrytëzimi i laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve. Ky program studimi nuk ka nevojë për laboratorë specifikë apo të dedikuar. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca 24_ Relacion i verifikimit te godines.pdf</i> <i>Evidencë 53: Permblendhje e tabelave.pdf</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Laboratorët e informatikës, janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës. Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit akademik me kualifikimin e duhur dhe IT e institucionit. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca 24_ Relacion i verifikimit te godines.pdf</i> <i>Evidencë 53: Permblendhje e tabelave.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira. Laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor. Specifikisht, ky program studimi nuk ka nevojë për laboratorë specifikë apo të dedikuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ konstatoi se lëndët referojnë literaturë të bollshme dhe kryesisht bashkëkohore me tekste mësimore të autorëve të njohur dhe ekspertëve ndërkombëtarë të fushës. Gjithësesi duhet thënë se ka disa raste ku kjo literaturë i përket botimeve të më shumë se 5 viteve më parë. <i>Në diskutimin që u bë me stafin akademik dhe përgjegjës të departamentit në lidhje me plotësimin e kërkesave ligjore për përdorimin e literaturës së 5 viteve të fundit, GVJ sugjeron përditësimin e literaturës së referuar.</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve_compressed (2) (2).pdf</i> <i>Evidenca 41_ Material per Biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 42_ Kerkese per libra.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	UMSH i kushton rëndësi përditësimit të literaturës. Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, u informuam se njësia bazë bënte herë pas here kërkesë për tekste dhe burime të tjera të nevojshme. Njësia bazë përgjegjëse, ruan përditësimet e literaturës që përfshihen në kopjet e syllabuseve për çdo semestër. <i>Evidenca 41_ Material per Biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 42_ Kerkese per libra.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në UMSH, GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës, e cila arkivon, digjitalizon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Biblioteka e UMSH, është e konceptuar dhe e implementuar në 4 salla leximi në një hapësirë prej 157 m². Ajo ofron shërbime për të gjithë studentët dhe stafin akademik të UMSH në mënyrë të barabartë. <i>Evidenca 41_ Material per Biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 42_ Kerkese per libra.pdf</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të	Biblioteka e UMSH është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore. Biblioteka mbulon modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit. Në bibliotekë studentët mund të gjejnë në format fizik dhe elektronik edhe leksionet e çdo lëndë




mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	nga pedagogët përkatës dhe slidet ne power point. Në ndihmë të studentëve janë dhe bibliotekat on-line të cilat mundësojnë të sigurohet akses në një literaturë të gjerë dhe të përditësuar në gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhën angleze të cilën studentët dhe stafi akademik e preferojnë. <i>Evidenca 41_Material per Biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 42_Kerkese per libra.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UMSH disponon akses në bibliotekën digjitale që nga viti 2021. Biblioteka online aksesohet përmes linkut ne faqen zyrtare të UMSH duke u loguar. Punimet shkencore dhe leksionet e përgatitura nga pedagogët janë gjithashtu të aksesueshme online në formatin pdf. Biblioteka ofron edhe shërbime online për kërkim në platformat e bibliotekave elektronike COBISS dhe Elgar Publishing. <i>Evidenca 41_Material per Biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 42_Kerkese per libra.pdf</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion, siç u shprehëm edhe më sipër, GVJ konstatoi se në UMSH ofrohet akses në Internet pa kufizim nëpërmjet wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online. Materialet gjenden lehtësisht si fizikisht dhe elektronikisht. <i>Evidenca 41_Material per Biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 42_Kerkese per libra.pdf</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka në UMSH është në dispozicion të studentëve dhe ofron shërbime për të gjithë studentët dhe stafin akademik. Shërbimi bibliotekar në UMSH ofrohet në gjashtë ditë të javës, nga a hëna në të shtunë, në orarin 08:00 – 20:00 për ditët nga e hëna në të premte dhe 09:00 – 14:00 ditën e shtunë. Oraret e funksionimit të bibliotekës janë të afishura në hyrje te bibliotekës. <i>Evidenca 41_Material per Biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 42_Kerkese per libra.pdf</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe	Vërehet një frymë bashkëpunimi mes departamenteve e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Lektorët e lëndëve të programit të studimit depozitojnë gjithmonë në bibliotekë një kopje të materialeve të leksioneve. Studentët dhe personeli akademik kanë akses në të gjitha fondet online. Me kërkesën dhe në bashkëpunim me departamentet parashikohen blerjet e reja të titujve të librave duke pasuruar vit pas viti në fondin e saj.




fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<i>Evidenca 41 _ Material per Biblioteken.pdf</i> <i>Evidenca 42 _ Kerkese per libra.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Literatura bazë e programit të studimit është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme janë kryesisht në gjuhë të huaj. Nga a hëna në të shtunë, në orarin 08:00 – 20:00 për ditët nga e hëna në të premte dhe 09:00 – 14:00 ditën e shtunë. UMSH ofron akses falas për studentët dhe stafin akademik në ambientet e bibliotekës, në bibliotekën online dhe platforma të tjera elektronike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UMSH disponon dhe administron informacionin e duhur për studentët, stafin akademik dhe personelin administrativ përmes një sistemi menaxhimi elektronik. Sistemi i Menaxhimit të Studentëve (SMS) përdoret rregullisht që nga viti 2017 për të ndjekur ecurinë e studentëve që nga regjistrimi deri në diplomim. Të dhënat që ruhen dhe përpunohen në SMS, ruhen njëkohësisht edhe në formatin hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Sistemi ka akses të vecantë për stafin akademik, administrativ dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit. <i>Evidenca 30 _ Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 45 _ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe	Sistemet e menaxhimit të informacionit në UMSH përdoren në përputhje me statutin e UMSH-së dhe Rregulloren e Njësisë Kryesore dhe aksesohen nga studentët, pedagogët, financa dhe sekretaria respektivisht sipas roleve që ato kanë në institucion.

aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përdoruesve të cilët pasi logohen me anë të emailit dhe fjalëkalimit kanë akses në të dhënat e tyre sipas rolit që kanë në institucion. Në këtë mënyrë administrohen të dhënat e studentëve dhe i ofrohet atyre një hapësirë vetjake/private për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Të dhënat dhe informacionet janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UMSH duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtarit të personelit akademik dhe administrativ. <i>Evidenca 30_ Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 1_ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 45_ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	SMS mundëson ndërveprimin mes aktorëve të institucionit duke lejuar hapjen dhe menaxhimin e adresave të emailit. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se për të menaxhuar në mënyrë efektive procesin mësimor online, sidomos gjatë vitit akademik 2020-2021, institucioni zbatoi edhe platformën G Suite me komponentët e Google Classroom dhe Google Meet. <i>Evidenca 30_ Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 45_ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit siguron adresa personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal. Gjithashtu, në dispozicion është aplikacioni SMS, faqja zyrtare e UMSH, G-Suite dhe sistemi Zoom Cloud. Në këtë mënyrë informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ. Në mënyrë automatike dhe të parametrizuar sistemi i menaxhimit gjeneron raportime në lidhje me kalueshmërinë, notën mesatare, përdormin e ambienteve didaktike të cilat përdoren nga strukturat vendimarrëse të institucionit. <i>Evidenca 30_ Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 45_ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme,	Në faqen zyrtare web të UMSH gjendet informacion për programet e studimit, partnerët, aktivitetet e ndryshme, etj. Në disa raste, GVJ konstatoi se informacionet në lidhje me stafin e angazhuar në këtë program studimi janë të kufizuara dhe për disa mungon një bio e




publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	shkurtër prezantuese. Gjithashtu, GVJ vëren që një pjesë e artikujve dhe informacioneve të publikuara ofrohen vetëm në gjuhën shqipe. GVJ rekomandon që institucioni, në kuadër të ndërkombëtarizimit, ti kushtojë vëmëndjen e duhur publikimit të cdo informacioni në faqen e tij web zyrtare në dy gjuhë. <i>Evidenca 30_ Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 45_ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i>			
Konkluzione	GVJ UMSH disponon nje Sistem Menaxhimi të Studentëve, me anë të të cilit bëhet edhe monitorimi i aktivitetit akademik për programin e studimit. Sistemi ka akses të vecantë për stafin akademik, adminsitrativ dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit. Në faqen zyrtare www.umshe.edu.al shumica e informacioneve publikohen në dy gjuhë shqip dhe anglisht. GVJ rekomandon që institucioni, në kuadër të ndërkombëtarizimit, ti kushtojë vëmëndjen e duhur publikimit të cdo informacioni në faqen e tij web zyrtare edhe në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UMSH harton raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar. Në to raportohet gjithashtu për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel institucioni mbulohet nga Administratori i UMSH dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe miratimin e Senatit Akademik, hartojnë dhe dakordësojnë cdo vit projekt-buxhetin vjetor dhe propozojnë kriteret për menaxhimin e burimeve financiare dhe materiale. Duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të UMSH, GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi. <i>Evidenca 16.1 Tabela e Raportit Financiar.pdf</i> <i>Evidenca 16.2_16.3_Pasqyrat financiare_Raporti i Auditit.pdf</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për	GVJ konstaton se në raportimin e dërguar nga UMSH janë të pasqyruara në nivel institucional realizimi i financimeve për

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Alina

[Signature]

programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	burimet njerëzore në shërbim të realizimit të programeve të studimit, shpenzimet për aktivitetin kërkimor shkencor, shpenzime për investime në teknologji, detyrimet financiare, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet, shërbimet trajnuese dhe zëra të tjerë. <i>Evidenca 16.1 Tabela e Raportit Financiar.pdf</i> <i>Evidenca 16.2_16.3_Pasqyrat financiare_Raporti i Auditit.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UMSH kryen auditim financiar vjetor të brendshëm dhe të pavarur të jashtëm cdo vit. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm të UMSH. Audit i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij. Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Pasqyrat financiare të institucionit janë transparente dhe pasqyrojnë gjendjen financiare të tij. Pasqyrat financiare auditohen edhe nga ekspertë të jashtëm që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht kryhen nga shoqëria CROWE Horwath AL shpk. <i>Evidenca 16.1 Tabela e Raportit Financiar.pdf</i> <i>Evidenca 16.2_16.3_Pasqyrat financiare_Raporti i Auditit.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UMSH realizon një Raport vjetor i cili përcillet deri në nivel njësie bazë dhe publikohet edhe në faqen web të UMSH. Alokimi i burimeve financiare në nivel njësie bazë bëhet mbi bazën e objektivave që ka secili departament në lidhje me veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore. <i>Evidenca 16.1 Tabela e Raportit Financiar.pdf</i> <i>Evidenca 16.2_16.3_Pasqyrat financiare_Raporti i Auditit.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfituara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Institucioni rezulton me fitim. Me qëllim diversifikimin e të ardhurave, institucioni vitet e fundit përparësi i ka dhënë edhe aplikimit për projekte shkencore dhe kërkimore. Institucioni ka aplikuar për projekte të ndryshme, disa




mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	prej të cilëve i ka fituar në partneritet me institucionet të tjera dhe disa nuk janë fituar. <i>Evidenca 16.1 Tabela e Raportit Financiar.pdf</i> <i>Evidenca 16.2_16.3_Pasqyrat financiare_Raporti i Auditit.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ UMSH rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare për të realizuar objektivat e tij lidhur me programin e studimit. Pjesa më e madhe e financimit vjen nga të ardhurat e studentëve. UMSH bën përpjekje për diversifikimin e të ardhurave duke synuar rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim. Institucioni nuk raporton pasqyra financiare me një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstatoi se UMSH ka politika dhe procedura të institucionalizuara të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin në përfundim të ciklit të studimeve. Të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MAS.
	<i>Evidenca 1 _Statuti UMSH.pdf</i>

	<i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ u informua se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi propozohet nga Departamenti. Kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi duhet të plotësojnë kriteret ligjore të cilat lidhen kryesisht me pasjen e një diplome bachelor në një fushë të përngjashme me fushën e studimit të programit. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. <i>Evidenca 1 _ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Përcaktimi i kriterëve pranuese në programin Bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” kalon për miratim në të gjitha njësitë përgjegjëse për këtë program studimi. GVJ sugjeron që kriteret dhe kuotat e miratura për këtë program studimi të publikohen edhe në faqen web zyrtare të UMSH. Nr i studentëve të regjistruar për cdo vit akademik, paraqitet si më poshtë: - Për vitin akademik 2023-2024, 13 studentë të regjistruar për herë të parë dhe 4 të transferuar, në total 17 studentë; - Për vitin akademik 2022-2023, 7 studentë të regjistruar për herë të parë dhe 8 të transferuar, në total 15 studentë; - Për vitin akademik 2021-2022, 8 studentë të regjistruar për herë të parë dhe 8 të transferuar, në total 16 studentë. <i>Evidenca 1 _ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Permbledhje e tabelave.pdf</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë	Rregulloret e institucionit, njësisë kryesore dhe programit të studimit kanë informacion të plotë për procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto informacione, studentët mund ti gjejnë në zyrat përkatëse në ambientet e institucionit. GVJ rekomandon institucionin që këto informacione ti mundësojë edhe online në faqen zyrtare web të UMSH.




lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë takimet informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera si reklamat nw kanale tw ndryshme, informimi nga Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, pjesëmarrja në evente dhe panaire lidhur me fushën e arsimit, publikimi në gazeta dhe revista, flyers, postera, prezantime, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit. Nga vizita në institucion, sidomos nga takimi me studentët, GVJ vëreu se studentët ishin të mirë-informuar mbi programin e studimit dhe të kënaqur nga niveli i informacionit që i vihej në dispozicion. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 31_ Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në këtë program studimi nuk kishte të regjistruar studentë me aftësi të veçanta apo nga shtresa të marginalizuara pasi edhe numri i studentëve ishte i limituar. Gjithësesi, nga vizita në institucion GVJ u informua se institucioni ofronte bursa ekselence si dhe bursa sociale ku përfshiheshin edhe persona nga shtresa të marginalizuara dhe me aftësi të kufizuara fizike. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 18_ Rregullore per studentet me aftesi ndryshe.pdf</i> <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Programi i studimit ofrohet vetëm në gjuhën shqipe duke mos lejuar kështu regjistrimin e studentëve të huaj. Gjithsesi, GVJ rekomandon që UMSH të përcaktojë kuota të dedikura për kandidatë nga republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, si dhe, në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit, mundësinë e zhvillimit të programit në gjuhë angleze, proces ky i fundit që i hap rrugën edhe pjesëmarrjes aktive në programin Erasmus duke garantuar shkëmbimet si të studentëve po ashtu edhe të stafit akademik. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i>

	<i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Referuar takimeve në institucion, dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB, UMSH aplikon politika për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike. Në zbatim të vendimit të Bordit të Administrimit, UMSH u ofron bursa kategorive të ndryshme të aplikantëve që duan të kryejnë cikle të ndryshme studimi. Vlen të përmenden këtu dy bursat më të përdorura, ajo e ekselencës dhe sociale. <i>Evidenca 1 _ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se UMSH/FI/DIB kanë hartuar, ndjekin dhe zbatojnë politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Gjithsesi GVJ kërkon që kriteret e pranimi për këtë program studimi të publikohen në faqen eeb si dhe të përcaktohen kuota të vecanta për studentët nga trojet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e kalimit të studentëve nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e UMSH dhe njësisë bazë që ofron programin, të cilat u vihen në dispozicion studentëve. Prezantimi i këtyre rregulloreve zhvillohet kryesisht në javën e parë të vitit akademik që i dedikohet orientimit studentor. Vlen këtu të theksohet fakti se sekretaria mësimore është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë vitit akademik për të informuar dhe ndihmuar studentët në lidhje me orarin mësimor, frekuentimin, datat dhe provimeve etj. <i>Evidenca 1 _ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i>



	<i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga institucione të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme. <i>Evidenca 1 _ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Elementët e detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në javën e parë të mësimit, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve syllabusin e lëndës dhe duke detajuar objektivat, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve si dhe literaturën përkatëse. <i>Evidenca 1 _ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve_compressed (2) (2).pdf</i> <i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ vëren se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit janë të përcaktuara qartë dhe saktë. Studentët e këtij programi studimi diplomohen me provim formimi dhe në fund pajisen me diplomë Bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”. <i>Evidenca 1 _ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2 _ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 20 _ Udhëzues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 21 _ Udhëzim mbi procedurat dhe afatet e sezonit te provimeve.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe	UMSH ka si mision të sajën që të drejtojë dhe mbështesë studentët gjatë të gjithë procesit të formimit universitar , si dhe t’i orientojë dhe këshillojë ata me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve. Institucioni merr pjesë në panairët e edukimit të zhvilluara nga MAS si p.sh. Panairi Eork & Study. GVJ

organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	u informua, si dhe ky informacion u konfirmua nga takimi me studentët, se në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime me studentët (aktual dhe potencial) për t'i informuar mbi programet e studimit. Të gjitha programet e studimit kanë një koordinator, i cili në bashkëpunim me skretarinë mësimore mundëson informacion dhe ofron suport për studentët aktual dhe potencial. <i>Evidenca 1 _Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2 _Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 20 _Udhëzues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 31 _Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 6 _Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>			
Konkluzione	<i>UMSH vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit.</i> <i>Pedagogët u bëjnë të njohur dhe u vënë në dispozicion studentëve syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</i> <i>Faqja eeb e UMSH luan një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij në fillim të vitit akademik. Një pjesë e informacioneve, si orari mësimor, struktura mësimore, datat e provimeve, konsultime, etj., janë të aksesueshme edhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të studentëve të UMSH, si dhe nëpërmjet klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Mirëkalo

H

	<i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 20_ Udhezues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 31_ Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në faqen ëeb të UMSH, studentët mund të aksesojnë online informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit si edhe planin mësimor. Klasat virtuale të krijuara nga pedagogët e lëndëve (Google Classroom) kanë informacion të plotë në lidhje me secilën lëndë si përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, menyrat e vlerësimit, organizimin e lëndës, literaturën, orain, etj. Gjithashtu një informacion të plotë për lëndët dhe informacion në lidhje me organizimin e studimeve studentët e marrin në javën informuese që organizon departamenti. <i>Evidenca 20_ Udhezues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 30_ Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 31_ Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në nivel institucional, GVJ vëren se UMSH është aktiv në mbështetjen e punësimit të studentëve duke marrë pjesë në panairë, takime me të profilin, etj. Institucioni informon si studentët potencialë dhe aktual mbi mundësitë e punësimit që ofron programi i studimit nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH-s, rrjeteve sociale, si dhe takimeve informimeve të kryera nga ZKSK. UMSH i mundëson studentëve kryerjen e praktikave profesionale, falë bashkëpunimeve dhe partneriteteve që ka me kompanitë, institucionet publike, IAL-të brenda dhe jashtë vendit sipas programeve të studimit që ofron dhe merr pjesë në panairin Ëork and Study të organizuar nga MAS. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 20_ Udhezues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 26_ Kalendari i Aktiviteteve.pdf</i> <i>Evidenca 31_ Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,	Nga sa jemi shprehur më sipër, bazuar në RVB si dhe në vizitën në institucion, studentëve i vihet në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm. Specifikisht, orari mësimor dhe plani mësimor afishohen në ambjentet e fakultetit, si dhe studentët informohen mbi

Alina

[Signature]

infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	infrastrukturonë në funksion të programit të studimit si klasat, biblioteka, laboratorët, hapësirat rekreative, etj. <i>Evidenca 1 _Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2 _Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 20 _Udhëzues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 31 _Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 6 _Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	UMSH zbaton prej vitesh Menaxhimin e Sistemit të Informacionit "SMS" i cili mundëson koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Nëpërmjet faqes së UMSH studentët mund të aksesojnë SMS dhe të komunikojnë me pedagogët dhe të shikojnë të dhënat që ata kanë hedhur në këtë sistem. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me stafin akademik GVJ-së iu konfirmua që çdo pedagog ndjek komunikimin elektronik me studentët. <i>Evidenca 2 _Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 20 _Udhëzues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 30 _Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 31 _Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 6 _Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7 _Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të qarta e të institucionalizuara mbi informimin e studentëve për organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme dhe mundësitë e punësimit. UMSH shpërndan informacion edhe nëpërmjet faqes zyrtare ëeb duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UMSH mban të dhëna statistikore vjetore per numrin e studenteve dhe të të diplomuarve. Të dhënat disponohen nga sekretaria mësimore, e cila i hedh në regjistrin e diplomimeve sipas kuadrit ligjor ne fuqi. Parelilisht, këto të dhëna mund të aksesohen në bazë rolesh dhe të drejtash të përdoruesve edhe brenda sistemit SMS.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrimit themeltar dhe regjistrimit të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MAS. Gjithsesi, ky program studimi akoma nuk ka diplomuar studentët e parë. <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Evidenca 45 _ Rregullore e Sekretarisë Mesimore.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ ndërmori një vizitë në sekretarinë mësimore e cila administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat mbahen në formë të shkruar në tre regjistra: Regjistri themeltar i studentëve; Regjistri i arritjeve akademike; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Këto të dhëna mbahen elektronikisht në Sistemin e Menaxhimit të Studentëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi sipas profileve për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon: - Për vitin akademik 2023-2024, 13 studentë të regjistruar për herë të parë dhe 4 të transferuar, në total 17 studentë; - Për vitin akademik 2022-2023, 7 studentë të regjistruar për herë të parë dhe 8 të transferuar, në total 15 studentë; - Për vitin akademik 2021-2022, 8 studentë të regjistruar për herë të parë dhe 8 të transferuar, në total 16 studentë. <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Permbledhje e tabelave.pdf</i> <i>Evidenca 45 _ Rregullore e Sekretarisë Mesimore.pdf</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen edhe në format elektronik, gjë që bën që ky informacion të jetë lehtësisht i aksesueshëm. Aksesit i të dhënave statistikore brenda sistemit SMS realizohet konform të drejtave dhe roleve të përdoruesve sipas rregulloreve institucionale dhe sipas organigramës së IAL-së duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Permbledhje e tabelave.pdf</i> <i>Evidenca 45 _ Rregullore e Sekretarisë Mesimore.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin	Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë dokumentacionit (sekretaritë mësimore). Veprimtaria e sekretarisë mësimore të UMSH mbështetet në rregulloren e UMSH, rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e Sekretarisë Mësimore.




e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Dokumentacioni që ruhet në Sistemin e Menaxhimit SMS është nën mbikqyrje të vazhdueshme nga specialistët e IT, duke garantuar menaxhimin e sigurt të informacionit dhe të të dhënave. <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Permbledhje e tabelave.pdf</i> <i>Evidenca 45_ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon : - Për vitin akademik 2023-2024, mesatarja në hyrje 8.4; - Për vitin akademik 2022-2023, mesatarja në hyrje 8.1; - Për vitin akademik 2021-2022, mesatarja në hyrje 7.5. Në lidhje me diplomimin dhe punësimin e studentëve, institucioni nuk ka paraqitur informacion, meqënëse programi akreditohe për herë të parë. <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Permbledhje e tabelave.pdf</i> <i>Evidenca 45_ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Sekretaria mësimore e Fakultetit të Informatikës mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik, regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave, ashtu dhe në format elektronik. Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës analizon gjendjen e punësimit të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	GVJ konstatoi se UMSH ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.

këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstaton që bazuar në Statutin dhe Rregullore e organizimit UMSH, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik dhe kanë të drejtë të organizohen në Këshillat Studentore. Studentët gjithashtu janë të përfaqësuar në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi. Në rregulloret institucionale nuk parashikohet përfaqësimi i studentëve në: - Asamblenë e personelit akademik; - Këshillin e Etikës - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave. GVJ rekomandon përditësimin e rregulloreve institucionale të UMSH dhe parashikimin e përfshirjes së studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse e këshilluese të UMSH. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 47_Rregullore e funksionimit të Këshillit Studentor.pdf</i> <i>Evidenca 2_Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në vizitën në institucion, GVJ evidentoi se studentët përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, në organizimet e ndryshme, në këshillin e studentëve ku gjenden senatorët e çdo viti dhe programi, si dhe në Senatin akademik. GVJ i qëndron sugjerimit me lart për përfshirjen e studentëve në të gjithë organet vendimmarrëse dhe këshilluese të UMSH-së. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2_Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të UMSH bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët merret mendimi si dhe sygjërimet për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Përpunimi i të dhënave të këtij pyetësori për çdo program studimi, i cili plotësohet para provimeve, në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Megjithatë, për shkak se programi akreditohet për herë të parë, nuk ka patur përmirësime të dokumentuara në kurrikulën e programit të studimit. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 2_Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i>




Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	UMSH aplikon disa metoda për përfshirjen e studentëve me qëllim tërheqjen e mendimit të tyre mbi cilësinë e programit të studimit si vijon: - Formularët për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve; - Mbledhjet e hapura të Departamentit; - Përmes studentit si përfaqësues në Senat; - Përmes studentit si përfaqësues në NJSBC; - Përmes fokus grupeve; Gjithashtu, bazuar në rregulloren e njësisë bazë, studentëve të këtij programi ju mundësohet e drejta për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e rezultateve dhe reflektimin e ndryshimeve. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 47_Rregullore e funksionimit te Keshillit Studentor.pdf</i> <i>Evidenca 2_Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i>			
Konkluzione	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e organizimit UMSH, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik, Këshillin Studentor dhe GVB. Pjesëmarrja e studentëve në disa nga organet vendimmarrëse të UMSH si dhe përpunimi i pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit. GVJ -rekomandon përditësimi i rregulloreve institucionale të UMSH dhe parashikimin e përfshirjes së studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse e këshilluese të UMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në UMSH funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si: - Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës - Sekretaria Mësimore

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	ZKSK mbështet Këshillin Studentor për mirëfunksionimin e tij dhe vë në dispozicion të grupeve të studentëve tutoriat dhe këshillim akademik sipas orareve të shpallura në fillim të vitit akademik. Sekretaria mësimore e FI është njësi ndihmëse në varësi të administratorit të UMSH e cila ndër të tjera koordinon punën e me fakultetet, departamentet, Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, Këshillin e Studentëve në mënyrë që të ndihmojë studentët në procesin mësimor. <i>Evidenca 2_ Rregullore e Organizimit UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 20_ Udhezues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 30_ Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 31_ Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Evidenca 45_ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Departamenti, Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës koordinojnë punën midis tyre dhe bashkëpunojnë për të vënë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik, për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të tyre, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor, programin e studimit, punësimin dhe tregun e punës, etj. Një rol të veçantë në informimin e studentëve luan dhe faqja zyrtare e UMSH dhe Sistemi i Menaxhimit të Studentëve (SMS) në të cilën studentët pasi logohen mund të aksesojnë të dhënat e tyre personale në lidhje me avancimin akademik. <i>Evidenca 20_ Udhezues per studentet.pdf</i> <i>Evidenca 30_ Manual i perdorimit te SMS.pdf</i> <i>Evidenca 31_ Broshura e programeve Bachelor.pdf</i> <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 7_ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Evidenca 45_ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit, krijon mundësi punësimi për studentët, organizon aktivitete në formën e trajnimeve, seminareve, ëorkshopeve dhe jep informacion dhe orientim për praktikën profesionale. <i>Evidenca 6_ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 48_ Rregullore e ZKSK.pdf</i>




mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Evidenca 45 _ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në UMSH, në varësi të Rektorit funksionon Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) e cila bazuar në rregullore, ndër objektivat e saj ka edhe nxitjen e frymës së bashkëpunimit ndërmjet UMSH dhe ish-studentëve në mënyrë që të promovohen dhe rriten interesat e UMSH ALUMNI-t. Në këtë kuadër, ZKSK organizon cdo vit në ambientet e UMSH takimin vjetor me studentët ALUMNI në të cilin diskutohet mbi tema të ndryshme, rrëfime personale dhe eksperiencat aktuale te punës. Gjithashtu, Institucioni organizon trajnime me studentët, ALUMNI-t dhe partnerët e biznesit në lidhje me vlerësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, përshtatjen e tyre dhe hapjen e programeve të reja. Ky program studimi nuk ka ende të diplomuar, duke qenë se është në përfundim të ciklit të parë dhe akreditohet për herë të parë. <i>Evidenca 6 _ Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 48 _ Rregullore e ZKSK.pdf</i> <i>Evidenca 7 _ Rregullore e Programit BSC MIN.pdf</i> <i>Evidenca 45 _ Rregullore e Sekretarise Mesimore.pdf</i>			
Konkluzione	Në UMSH funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) dhe Sekretaria Mësimore, njësi të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. ZKSK organizon cdo vit takimin vjetor me studentët ALUMNI në të cilin diskutohet mbi tema të ndryshme, rrëfime personale dhe eksperiencat aktuale te punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga UMSH dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). GVJ vlerëson punën që ka bërë Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në propozimin dhe analizën e metodave inovative në procesin e mësimdhënies në programin e studimit. DSHPMN ka kryer një studim në lidhje vlerësimin e efektivitetit të metodave të ndryshme inovative me qëllim adaptimin e tyre në mësimdhënie në programet e studimit që ajo ofron. <i>Evidenca 30_ Manual i përdorimit të SMS.pdf</i> <i>Evidenca 25_ Programi i Trajnimeve.pdf</i> <i>Evidenca 26_ Kalendari i Aktiviteteve.pdf</i> <i>Evidenca 19_ Leksione të hapura.pdf</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	DSHPMN është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit. Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. GVJ konstaton që NJSBCZHK përgatit një plan veprimi vjetor për monitorimin e cilësisë në institucion. Konkretisht, ajo është përgjegjëse për hartimin dhe realizimin e anketimeve për matjen e performancës së pedagogëve në procesin mësimor, organizimin e punës me fokus grupet dhe për vlerësimin e punës me studentët. <i>Evidenca 26_ Kalendari i Aktiviteteve.pdf</i> <i>Evidenca 27_ Formulari i Vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf</i> <i>Evidenca 28_ Plani i Monitorimit.pdf</i> <i>Evidenca 29_ Procedurat e punës me fokus grupet.pdf</i> <i>Evidenca 49_ Rregullore për organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_ Plani i Punës NJSBCZHK.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave	Garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lektorëve të




e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	lëndëve të programit të studimit. Ky pyetësor plotësohet në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. Pyetësori është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBCZHK, e cila harton një raport vjetor të punës së saj dhe ja paraqet Komisionit të përhershëm. Kopje e raportit përcillet për dijeni dhe informim në Dekanat dhe miratohet në Senatin Akademik. <i>Evidenca 28_Plani i Monitorimit.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 29_Procedurat e punes me focus grupet.pdf</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Përpunimi i anketimeve dhe vlerësimi i pedagogëve sipas qëllimit të anketimit shoqërohet me një raport. Materialet e anketimeve i vihen në dispozicion: Njësisë Kryesore, Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Rektoratit. Bazuar në këto rezultate dekanati vlerëson punën e cdo pedagogu dhe në rast problematike zhvillon diskutime individuale për zgjidhjen dhe përmirësimin e tyre. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	NJSBCZHK luan një rol të rëndësishëm në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. NJSBCZHK përgatit një plan veprimi vjetor për monitorimin e cilësisë në institucion. Ajo njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare të monitorimit të cilësisë dhe rezultateve të pyetësorëve. Këta të fundit marrin masa të promovojnë dhe nxisin personelin akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. <i>Evidenca 28_Plani i Monitorimit.pdf</i> <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga UMSH dhe ato shtetërore të cilësisë. NJSBCZHK drejton në nivel institucioni punën për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Dekanati vlerëson punën e cdo pedagogu dhe në rast problematike zhvillon diskutime individuale për zgjidhjen dhe përmirësimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht




Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Strukturat përgjegjëse në nivel institucional për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në UMSH është Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) e cila është në varësi të Rektorit. Bazuar në Statutin e UMSH, NJSBCZHK konsiderohet si organ ndihmës në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Detyrat dhe përgjegjësitë e NJSBCZHK përcaktohen në rregulloren e saj. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 4_Plani Strategjik i Zhvillimit.pdf</i> <i>Evidenca 5_Strategjia e Zhvillimit BSc MIN.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në nivel institucional, NJSBCZHK, përbëhet nga 9 anëtarë personel akademik me kohë të plotë ose ndihmës akademik dhe 1 anëtar student i një prej degëve të studimit në UMSH. NJSBCZHK monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, të syllabuseve, zhvillimit të provimeve, praktikave, diplomave, etj. Ajo në themel të punës së saj ka zbatimin e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të cilin e realizon nëpërmjet mbikëqyrjes së proceseve të vlerësimit të brendshëm <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Akreditimi i jashtëm kryhet periodikisht në UMSH. Institucionit i është akredituar institucionalisht me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 62, datë 18.12.2020, deri më 17.12.2026, por për herë të fundit, me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 54, datë 13.01.2024 me një kohëzgjatje 2 vite u akreditua pjesërisht për fakultetin e ri. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”, me qëllim akreditimin e tij, po realizohet për herë të parë nga ASCAL. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i>

	<i>Evidenca 49_ Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_ Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga evidencat e depozituara në DVV dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në institucion, duket se ky proces është institucionalizuar dhe rutinizuar. Gjithësesi, mbetet me rëndësi që të mos transformohet në një ushtrim formal, por të ruajë karakterin substancial pasi është thelbësor. GVJ vëren se në tërësi pesha kryesore e proceseve të mësipërme bie mbi drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore për të zbatuar masat organizative dhe monitoruese për procesin mësimor dhe kërkimor. NJSBCZHK, shërben si strukturë që mbledh të dhëna me qëllim që drejtuesit të marrin masa në promovime apo edhe largime, kur e kërkon rasti. <i>Evidenca 1_ Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_ Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_ Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i>			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni ka krijuar dhe zbatuar në mënyrë kapilare procedura të dedikuara e publike për sigurimin e bendshëm të cilësisë. Informacioni i siguruar nga këto struktura i përcillet drejtuesve të cilat i përdorin për të përmirësuar politikat e brendshme dhe orientuar burimet mbështetëse. GVJ gjithashtu vëren se barra kryesore e këtyre procesve bie mbi njësinë bazë dhe kryesore, duke përdorur të dhënat e siguruar nga NJSBCZHK.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e	GVJ konstaton se NJSBCZHK prodhon raporte analitike të cilat përfshijnë sugjerime të studentëve nga vlerësimi i pedagogut dhe lëndës përmes pyetësorëve, sondazheve e fokus grupeve të studentëve të të gjitha viteve dhe programeve. Të gjitha udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore ndiqen dhe zbatohen. Këto analiza përdoren nga drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore për të monitoruar cilësinë, ndërhyrë kur është e nevojshme dhe promovuar një kulturë cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Alina

8

praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	NJSBCZHK operon në mënyrë të pavarur për vlerësimin dhe monitorimin e proceseve të ndryshme duke respektuar planveprimin vjetor të miratuar nga Rektori në fillim të vitit akademik. Rektorati dhe drejtuesit e njësisë bazë njoftohen me email përpara cdo fillimi të një procesi monitorimi. NJSBCZHK njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare të monitorimit të cilësisë dhe rezultateve të pyetësorëve. <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 28_Plani i Monitorimit.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në UMSH përdoren disa metoda të drejtpërdrejta vlerësimi si dëgjime në auditor, një procedurë e mirëpërcaktuar dhe miratuar nga Rektori. Vëzhgime në auditor, ku drejtuesi i departamentit dhe NJSBCZHK kryejnë vëzhgime mbi mbarëvajtjen e procesit të provimeve. Një mënyrë tjetër është ajo e monitorimit të të korigjimit të provimeve, ku vlerësohen respektimi i afateve, formatit, mënyrën e korigjimit e tjerë. Gjithashtu kryhet e monitorimi i zbatimit të akteve ligjore dhe formale të syllabuseve nga anëtarët e NJSBCZHK. Këto ajnë disa nga metodat e drejtpërdrejta që insitucioni përdor për të vlerësuar programin e studimit. <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 28_Plani i Monitorimit.pdf</i> <i>Evidenca 27_Formulari i Vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Në UMSH përdoren mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit. Në tërësi, për vlerësimin e programit të studimit, NJSBCZHK përdor instrumenta të




studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	drejtpërdrejta dhe të tërthorta përcaktuar në Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Instrumentet e përdorura përfshijnë pyetësorët me studentët, fokus grupet, pyetësorë për pedagogët, takimet e përbashkëta me pedagogët dhe departamentet, dhe intervista me studentët dhe takime me stafin administrativ. Gjithashtu, njësia bazë zhvillon analizën vjetore për çdo vit akademik ku trajton me detaje ecurinë e programeve të studimit dhe ndërhyrjet potenciale në të ardhmen. <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 28_Plani i Monitorimit.pdf</i> <i>Evidenca 23_Formular i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti.pdf</i> <i>Evidenca 29_Procedurat e punes me focus grupet.pdf</i>			
Konkluzione	Në UMSH ndiqen dhe zbatohen të gjitha udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Raportet e vetëvlerësimit, në të cilët jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik hartohen në nivel institucioni. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe tërthorta të vlerësimit në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në UMSH, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBCZHC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. <i>Gjithsesi, GVJ konkludon se IAL nuk ka përfshirje të strukturuar të aktorëve të jashtëm në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Rekomandohet që në përbërje të kësaj njësie të jetë edhe një përfaqësues i jashtëm, duke sjellë një qasje tjetër dhe me vlerë në të gjithë proceset vlerësuese që institucioni kryen.</i> <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i>

	<i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 8_Rregullore DSHPMN.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rregullorja e NJSBCZHC përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Rregullorja synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmblusur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë UMSH, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 8_Rregullore DSHPMN.pdf</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Nga takimet në institucion, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundur një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmblusjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. Në përmirësimin e cilësisë së programit një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetësorët e studentëve, puna me fokus grupet si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 8_Rregullore DSHPMN.pdf</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në punën e saj NJSBCZHC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe në anketimet e kryera në veçanti. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 8_Rregullore DSHPMN.pdf</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë	Për të siguruar vlerësime sa më të besueshme, të pavarura dhe profesionale, UMSH në bashkëpunim me NJSBCZHC, ka zhvilluar takime në institucion, ku ka përfshirë, studentë, ALUMNI dhe partnerë biznesi me qëllim vlerësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës dhe hapjen e programeve të reja. <i>Gjithsesi, GVJ i qëndron</i>




lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<i>mendimit më sipër që pjesë e NJSBCZHC duhet të jetë edhe një ekspert i jashtëm.</i> <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 6_Rregullore e FDSHH.pdf</i> <i>Evidenca 8_Rregullore DSHPMN.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Në UMSH, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBCZHC, e cila synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. NJSBCZHC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. Gjithsesi, GVJ i qëndron mendimit më sipër që pjesë e NJSBCZHC duhet të jetë edhe një ekspert i jashtëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta dhe njësi të dedikuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas kërkesave ligjore. Nga vizita u konstatua që raportimi në RVB përputhej me situatën reale. Pegadogët bënin vetëvlerësim, zyra e sigurimit të cilësisë kryente sondazhet, të dhënat përpunoheshin dhe problematikat e identifikuar përcilleshin dhe adresoheshin në instancat e përshtatshme. Në organikën e UMSH është zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave me detyrë të monitorojë dhe promovojë cilësinë si dhe të identifikojë problematikat e ndryshme dhe të koordinohet me instancat përgjegjëse për adresimin e tyre. IAL, dhe njësitë përgjegjëse, i kushtonin rëndësi sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe merrnin masa që të promovonin cilësinë në çdo hallkë të proceseve që lidheshin me këtë program studimi. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 4_Plani Strategjik i Zhvillimit.pdf</i>

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ vëren se njësia përgjegjëse për kontrollin e brendshëm të cilësisë kryen dy anketime në vit për të gjitha lëndët në të dy semestrat e vitit akademik. Anketimet zhvillohen në fund të semestrit përpara se studenti të marrë notën. Të gjithë studentët që janë të pranishëm në klasë marrin pjesë në anketim rezultatet e të cilit përpunohen nga zyra e sigurimit të cilësisë. Të dhënat përfshihen në një raport vjetor i cili nuk përmend emra por identifikon tematika të rëndësishme të cilat më pas bëhen pjesë a planit të punës për njësitë bazë dhe të njësisë së kontrollit të brendshëm të cilësisë. <i>Evidenca 1_Statuti UMSH.pdf</i> <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ vëren se rezultatet e vlerësimit i përcillen zyrës së burimeve njerëzore, drejtuesve të njësisë bazë dhe kryesore ku prezantohen gjetjet në rang njësie dhe problematikat e tjera në nivel pedagogu. Këto të dhëna pasi përpunohen, përcillen në zyrën e burimeve njerëzore dhe bëhen pjesë e një dosjeje e cila përfshin vëtvlerësimin e pedagogut, vlerësimin e dekanit/shefit të departamentit si edhe pyetësorët e studenteve. Bazur në të gjitha këto gjetje të strukturuar në një dosje vlerësuese, drejtuesit e njësisë bazë zhvillojnë takime me pedagogët për të identifikuar mënyrat më të mira për të zgjidhur problematikat e hasura. <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 28_Plani i Monitorimit.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga ana e UMSH, GVJ konstaton përpjekje në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në lidhje me këtë program studimi. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që UMSH i jep këtij procesi. <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 33_Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 28_Plani i Monitorimit.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Procesi i realizimit të pyetësorëve kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Ndikim pozitiv në këtë drejtim ka dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative (Senat dhe NJSBCZHC) në të cilat diskutohen problematika që kanë lidhje me përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. <i>Evidenca 49_Rregullore per organizimin NJSBCZHK.pdf</i>

	<i>Evidenca 33 _Plani i Punes NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca 28 _Plani i Monitorimit.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta dhe njësi të dedikuara për sigurimin e brendshëm të cilësish sipas kërkesave ligjore. Të dhënat përfshihen në një raport vjetor i cili nuk përmend emra por identifikon tematika të rëndësishme të cilat më pas bëhen pjesë a planit të punës për njësitë bazë dhe të njësisë së kontrollit të brendshëm të cilësisë. GVJ konstaton përpjekje në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në lidhje me këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti ka një kuadër të plotë ligjor dhe rregullator që mundëson realizimin e procesit mësimor, kërkimor e shkencor dhe një praktikë shumë të mirë të ruajtjes së dokumentacionit sipas standardeve dhe kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Programi i studimit është riorganizuar për t’ju përshtatur më mirë Planit strategjik të zhvillimit, statutit dhe rregullores së UMSH dhe kërkesave të tregut të punës, dhe është në harmoni me interesat kombëtare të vendit.
3. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit ka eksperiencën dhe kualifikimet e duhura, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit.
4. Përdorimi i metodave interaktive dhe përfshirja e studentëve në këtë proces, evidentohet si një pikë e fortë e këtij programi studimi.
5. Institucioni ka ndërtuar bashkëpunime të frytshme me institucionet publike e jopublike në vend si dhe me universitetet e huaja.
6. Institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si klasa, laboratorë salla të pajisura me kompjutera, projektor, smart board, lidhje internet të përshtatshme për nevojat e zhvillimit të orëve mësimore, të programit bachelor Marrëdhënie dhe institucionet ndërkombëtare.

Pika të dobta:

1. Ka mospërputhje të fushës së programit të studimit me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Bazuar në kategorizimin e ISCED, programi dhe njësia kryesore janë në nivele të ndryshme. **(Standardi I, Kriteri V).**
2. Literatura në disa raste rezulton e vjetëruar dhe jo e azhornuar me botime të 5 viteve të fundit. **(Standardi IV.3, Kriteri 1)**

Rekomandime:

1. Referuar mospërputhjes së fushës së programit të studimit me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane, kërkohet reflektim nga institucioni.
2. GVJ sugjeron përditësimin e literaturës së referuar duke e pasuruar programin e studimit me tituj të 5 viteve të fundit.
3. GVJ rekomandon që institucioni, në kuadër të ndërkombëtarizimit, ti kushtojë vëmendjen e duhur publikimit të cdo informacioni në faqen e tij web zyrtare në dy gjuhë.
4. GVJ sugjeron që kriteret dhe kuotat e miratura për studentët për këtë program studimi të publikohen edhe në faqen eeb zyrtare të UMSH, si dhe të përcaktojnë kuota të vecanta për studentët nga trojet (Kosovë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut).

5. GVJ rekomandon përditësimin e rregulloreve institucionale të UMSH dhe parashikimin e përfshirjes së studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse e këshilluese të UMSH.
6. Rekomandohet që në përbërjen e NJSBCZHK të jetë edhe një përfaqësues i jashtëm, duke sjellë një qasje tjetër dhe me vlerë të shtuar në të gjithë proceset vlerësuese që institucioni kryen.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in “International Relations and Institutions” offered by the Higher Education Institution “Mediterranean University of Albania”

Strengths and affirmations

1. The University has a complete legal and regulatory framework that enables the implementation of the teaching, research and scientific process and a very good practice of maintaining documentation according to the standards and legal and sub-legal requirements in force.
2. The study program has been reorganized to better adapt to the Strategic Development Plan, the statute and regulation of UMSH and the requirements of the labor market, and is in harmony with the national interests of the country.
3. The academic staff engaged in the study program has the necessary experience and qualifications, in order to fulfill the objectives of the study program.
4. The use of interactive methods and the involvement of students in this process is evidenced as a strong point of this study program.
5. The institution has built fruitful collaborations with public and non-public institutions in the country as well as with foreign universities.
6. The institution provides sufficient and suitable facilities for the development of teaching activities, such as classrooms, laboratories, halls equipped with computers, projectors, smart boards, and internet connections appropriate to the needs of the development of the teaching schedule, of the bachelor's program in International Relations and Institutions.

Weaknesses

1. There is a discrepancy in the field of the study program with the main unit, the Faculty of Law and Humanities. Based on the ISCED categorization, the program and the main unit are at different levels. *(Standard I, Criterion V).*
2. The literature in some cases is outdated and not updated with publications from the last 5 years. *(Standard IV.3, Criterion 1)*

Recommendation

1. Referring to the inconsistency of the field of the study program with the main unit, the Faculty of Law and Humanities, reflection is required from the institution.
2. EEG suggests updating the referenced literature by enriching the study program with titles from the last 5 years.




3. EEG recommends that the institution, within the framework of internationalization, pay due attention to publishing any information on its official website in two languages.
4. EEG suggests that the criteria and quotas approved for students for this study program be published on the official website of UMSH, as well as to determine special quotas for students from the territories (Kosovo, Montenegro, North Macedonia).
5. EEG recommends updating the institutional regulations of UMSH and providing for the inclusion of students in all decision-making and advisory bodies of UMSH.
6. It is recommended that the composition of the IQAU also include an external representative, bringing a different and value-added approach to all evaluation processes that the institution carries out.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X